



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

FUNKSIONIMI, LICENCIMI DHE MBIKËQYRJA E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Prishtinë, gusht 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollë”, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Ariana Gjonbalaj Shala, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Ylfete Osmani, Udhëheqëse e Ekipit

Ardiana Miftari, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi 210, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +381(0) 38 60 60 04/1

¹ Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

³ Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PERMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	1
1 Hyrje	4
2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit	5
Pyetjet e auditimit	5
3 Gjetjet e auditimit.....	7
3.1 Zhvillimi i aktiviteteve të deritanishme në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit	10
3.2 Procedurat e licencimit dhe monitorimit Procedurat jo efikase të licencimit	16
3.3 Zhvillimi i kapaciteteve nëpër komuna dhe funksionimi i Institucioneve Parashkollore Publike.....	26
3.4 Menaxhimi i Institucioneve Parashkollore Publike nga Drejtoritë Komunale të Arsimit	33
4 Konkluzionet	39
5 Rekomandimet	41
6 Shtojca 1. Fushëveprimi, metodologjia dhe përshkrimi i sistemit.....	42
Fushëveprimi i auditimit	42
Metodologjia e auditimit	42
7 Shtojca 2. Përshkrimi i sistemit, pyetjet dhe kriteret e auditimit	44
8 Shtojca 3. Investimet për zhvillim të kapaciteteve publike	49
9 Shtojca 4: Të dhëna për Inspektoratin e Arsimit	50
10 Shtojca 5 . Rezultatet e observimit të paraqitura në formë tabele.....	52
11 Shtojca 6: Letër konfirmimet dhe komentet e entiteteve.....	55

Lista e shkurtesave

EFH – Edukimi në fëmijërinë e hershme

EP- Edukimi Parashkollorë

IP – Institucionet Parashkollore

UNICEF - Organizata e Kombeve të Bashkuara, Fondi Ndërkombëtar Emergjent për Fëmijë (United Nations International Children's Emergency Found)

UNESCO – OKB, Organizata Ndërkombëtare e Edukimit, Shkencës dhe Kulturës (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization)

IEP- Institucionet e Edukimit Parashkollorë

MASHTI- Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (Ministria)

DEFH - Divizioni për Edukim në Fëmijërinë e Hershme

DAPP – Divizioni për Arsim Privat Para-universitar

DAP- Departamenti i Arsimit Para-universitar

DKA- Drejtoria Komunale e Arsimit

IA - Inspektorati i Arsimit

SIA – Sektori i Inspektoratit të Arsimit

Përmbledhje e përgjithshme

Edukimi gjatë fëmijërisë është kusht bazik dhe e drejtë themelore e çdo fëmije, e mbrojtur me konventa ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Edukimi në Fëmijërinë e Hershme luan një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe siguron një bazë të fortë për zhvillimin e mëvonshëm në aspektin emocional, edukativ dhe social.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar auditimin e performancës, “Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore”, duke pasur për objektive vlerësimin e organizimit të procesit të edukimit në fëmijërinë e hershme, shfrytëzimin dhe zhvillimin e kapaciteteve, si dhe vlerësimin e funksionimit të institucioneve parashkollore. Njëkohësisht është vlerësuar mbikëqyrja dhe monitorimi i institucioneve parashkollore nga të gjitha palët përgjegjëse.

Auditimi është fokusuar në analizimin e infrastrukturës ligjore dhe funksionimin e sistemit qeverisës në nivelin qendror dhe lokal, siç janë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit në Komunitet Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren. Fushëveprimi i auditimit përfshinë periudhën kohore 2022/2024 dhe mbështetet në analizën e dokumenteve zyrtare, intervista me palët e përfshira dhe vlerësimin e rezultateve të arritura në krahasim me objektivat dhe kriteret e përcaktuara.

Rezultatet e auditimit tregojnë se pavarësisht iniciativave ligjore dhe përpjekjeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për të avancuar edukimin në fëmijërinë e hershme, sistemi ekzistues përballet me sfida të theksuara në aspektin strukturor, menaxherial dhe zbatues. Mungesa e infrastrukturës ligjore sekondare, si dhe e mekanizmave funksional për monitorim, licencim dhe inspektim të institucioneve parashkollore, pamundëson zbatimin efektiv të politikave arsimore në këtë sektor. Në nivel lokal, ndonëse janë evidentuar disa përparime në ndërtimin e objekteve të reja parashkollore dhe në realizimin e monitorimeve të pjesshme, mungesa e planeve zhvillimore afatgjata, rregulloreve të brendshme të funksionimit dhe përfshirja e pamjaftueshme e të gjitha grup moshave e pengojnë ndjeshëm sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe cilësor të edukimit parashkollore. Për më tepër, kërkesat në rritje nga komuniteti dhe sektori për themelimin dhe licencimin e institucioneve të reja parashkollore, si dhe nevoja për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese, mbeten të larta dhe të paplotësuara.

Mungesa e udhëzimeve administrative e ka bërë të pazbatueshëm ligjin e ri për edukimin në fëmijërinë e hershme. Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit nuk ka hartuar udhëzuesit administrativ që burojnë nga Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i miratuar në vitin 2023. Procesi i krijimit të strukturës së nevojshme ligjore nuk ka kaluar as fazën fillestare të draftimit. Deri në momentin e auditimit, asnjë prej udhëzimeve administrative të parashikuara nuk ishte finalizuar apo aprovuar, ndonëse kanë kaluar pothuajse dy vite nga hyrja në fuqi e ligjit. Mosmiratimi i këtyre akteve nënligjore ka pamundësuar zbatimin praktik të ligjit të ri. Si pasojë, institucionet parashkollore vazhdojnë të funksionojnë sipas rregulloreve dhe udhëzimeve të mëparshme, të cilat nuk janë në harmoni me dispozitat dhe kërkesat e ligjit aktual, duke krijuar paqartësi dhe mospërputhje në zbatimin e tij.

Mungesa e mbikëqyrjes efektive nga Inspektorati i Arsimit ka krijuar paqartësi në funksionimin e institucioneve parashkollore. Sektori Regjional i Inspektimeve në Prishtinë dhe Prizren ka mbuluar 30

deri 31% të inspektimeve për institucionet parashkollore. Përderisa, Sektori Regjional i Inspektimeve në Gjakovë nuk ka zyrtarë përgjegjës të angazhuar në inspektime dhe mbikëqyrje të institucioneve të arsimit. Po ashtu, Inspektorati i Arsimit nuk posedon rregullore, akte nënligjore apo dokumente tjera të brendshme që do ta mbështesnin organizimin e punës së zyrtarëve inspektues. Një zbrazëti të theksuar për çështjet e organizimit të stafit lë mungesa e Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës. Angazhimet e inspektorëve bëhen sipas përshkrimit të përgjithshëm të Ligjit mbi Inspektoratin e Arsimit.

Mungesa e mekanizmave efikas për licencim dhe monitorim nga Divizioni për Edukim në Fëmijërinë e Hershme ka ndikuar në vonesa, parregullsi dhe funksionim të pakontrolluar të institucioneve parashkollore. Divizioni për Edukim në Fëmijërinë e Hershme nuk ka krijuar mekanizma efikas për procesin e licencimit, shqyrtimin e kërkesave dhe monitorimin e institucioneve parashkollore të licencuara. Procedurat e licencimit të institucioneve parashkollore të sektorit privat, me bazë në komunitet dhe publiko privat, zhvillohen pa afate të qarta kohore. Si rezultat, janë evidentuar vonesa të konsiderueshme në trajtimin e kërkesave të pranuar, ku disa janë shqyrtuar brenda një jave, ndërsa të tjera kanë mbetur në pritje prej 2-3 muaj deri në dy vite. Për më tepër, mungesa e një sistemi funksional të monitorimit nga ky divizion ka ndikuar në shfaqjen e parregullsive gjatë funksionimit të institucioneve parashkollore përfshirë: tejkalimin e numrit të fëmijëve në raport me vendimin për licencë, mbylljen e institucioneve parashkollore pa njoftuar zyrtarët dhe autoritetet përgjegjëse si dhe funksionimin e disa institucioneve në kushte të pa përshtatshme për zhvillimin dhe sigurinë e fëmijëve.

Mungesa e planeve zhvillimore dhe vështirësitë administrative në nivelin lokal kanë penguar përmbushjen e objektivave për zgjerim të kapaciteteve dhe përfshirje më të lartë të fëmijëve në edukimin parashkollor. Në nivelin lokal, nuk janë arritur objektivat për zgjerimin e kapaciteteve dhe rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme. Drejtoria Komunale e Arsimit Prishtinë nuk ka hartuar planin zhvillimor të arsimit për vitet 2022-2024, çka ka ndikuar në mungesë drejtimi strategjik për zhvillimin e sektorit parashkollor. Në Komunën e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit ka hasur në pengesa për realizimin e të gjitha procedurave administrative që lidhen me emërimin dhe funksionalizimin e institucioneve të reja publike parashkollore. Për më tepër, kjo drejtori nuk ka përfshirë në institucionet publike kategorinë më të ndjeshme të fëmijëve, ata të moshës 0-3 vjeç. Ky veprim ka kufizuar qasjen e moshave më të reja të fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike edhe pse fushëveprimi i ligjit për EFH përfshinë të gjitha moshat nga lindja deri në gjashtë vjeç. Gjendja ndryshon në komunën tjetër, më konkretisht Drejtoria Komunale e Gjakovës ka treguar performancë më të mirë, duke arritur të përmbushë në masë më të madhe nevojat për zgjerim të kapaciteteve teknike të institucioneve parashkollore dhe duke sistemuar të gjitha grup moshat e fëmijëve, nga 9 muaj deri në 6 vjeç.

Mungesa e sistemit të monitorimit apo të përcaktimit të stafit dhe rregulloreve për EFH, ka ndikuar në menaxhim të paorganizuar dhe pa mbikëqyrje të rregullt të institucioneve parashkollore publike në Prishtinë dhe Prizren. Për më tepër, në Drejtorinë Komunale të Arsimit Prishtinë, mungon një sistem funksional dhe i dokumentuar për vlerësimin dhe monitorimin e institucioneve parashkollore. Nuk ekzistojnë të dhëna të qarta se sa herë brenda vitit dhe në çfarë periudhe kohore monitorohen, cilat janë mangësitë e identifikuara si dhe masat që duhet marrë për përmirësimin e tyre. Kurse DKA e Prizrenit nuk ka emëruar zyrtar përgjegjës për këtë nivel të edukimit. Këto ngecje sistemore dhe

operacionale e vështirësojnë funksionimin efektiv dhe të qëndrueshëm të institucioneve parashkolllore.

Për përmirësimet e duhura janë dhënë gjithsej tetë rekomandime. Pesë rekomandime janë dhënë për Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe tre rekomandime për Drejtoritë Komunale të Arsimit.

Përgjigjja e palëve të përfshira në auditim

Komuna e Gjakovës është pajtuar me të gjeturat e këtij raporti dhe nga ana e tyre kemi pranuar letërkonfirmimin, kurse Komuna e Prishtinës dhe e Prizrenit nuk kanë dërguar letër konfirmime. Ministria e Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Inovacionit po ashtu ka dorëzuar letërkonfirmimin dhe është pajtuar pjesërisht me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, komentet e ministrisë i gjeni në *Shtojcën 6: Letërkonfirmimet dhe komentet e palëve të audituara*

1 Hyrje

Edukimi gjatë fëmijërisë është kusht bazik dhe e drejtë themelore e çdo fëmije, e mbrojtur me konventa ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (tutje EFH) luan një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe siguron një bazë të fortë për zhvillimin e mëvonshëm në aspektin emocional, edukativ dhe social.⁶ Mosha e hershme e fëmijërisë, llogaritet si periudhë kritike e jetës që ka ndikim në shëndetin mental dhe fizik të njeriut. Në këtë moshë, truri i njeriut absorbon dhe përvetëson thellësisht të gjitha njohuritë bazike, zhvillon shkathtësitë e komunikimit dhe ato motorike, si dhe adapton sjelljet me normat ekzistuese sociale.⁷ Bazuar në këtë, mund të konstatohet se kjo moshë është periudha kur qenia njerëzore pëson një transformim të plotë si në zhvillimin e personalitetit ashtu edhe në formimin e identitetit.⁸ Andaj është e rëndësishme të merren të gjitha masat për të siguruar kushtet e duhura për zhvillimin e edukimit të mirëfilltë të fëmijëve gjatë kësaj periudhe kohore.

Marrë parasysh rëndësinë e këtij niveli të edukimit në aspektin global, konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve përcakton se çdo shtet duhet të marrë të gjitha masat legislative dhe organizative me qëllim të sigurimit të mirëqenies së fëmijëve të kësaj grup moshe.⁹ Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (tutje ASK), numri i fëmijëve të grup moshës 0-6 vjeçare në vendin tonë është 154,471 fëmijë, kurse në ciklin e edukimit parashkollorë në të dy sektorët, publik dhe atë privat, përfshihen 32,818 fëmijë.¹⁰

Në aspektin legjislativ në Kosovë, përfshirja e fëmijëve në edukim të hershëm, gjegjësisht në nivelin para fillor, nuk ka qenë e obliguar deri në vitin 2023. Një ndryshim në këtë aspekt ka pasur aprovimi i ligjit të ri për Edukimi në fëmijërinë e hershme, që obligon nivelin e edukimit para fillor për të gjithë fëmijët nga mosha 5-6 vjeçare.

Në Kosovë janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të arritur një edukim cilësor në gjeneratat më të reja, në kuadër të Institucioneve Parashkollore (tutje IP), aty ku edhe zhvillohet ky nivel i edukimit. Sipas kësaj dhe bazuar në sistemin tonë qeverisës, IP-të janë të organizuara në disa kategori; publike, private, të kombinuara (publiko-private), si dhe me bazë në komunitet.

Referuar Agjendës së Komisionit Evropian për Reformat në shtetet e Ballkanit Perëndimorë, është e domosdoshme që Kosova të investoj në EFH dhe të shtoj kujdesin për avancimet infrastrukture

⁶ American Public University, <https://www.apu.apus.edu/area-of-study/education/resources/why-is-early-childhood-education-important-for-children/>

⁷ Very well mind, Critical period in brain development; definition & importance, July 25,2023 <https://www.verywellmind.com/critical-period-in-brain-development-definition-importance-7556041#:~:text=The%20early%20years%20of%20a%20child's%20life%2C%20from%20birth%20to,being%20learned%20and%20processed%20extensively.>

⁸ Roli i edukimit te femijerise se hershme, Bissoli, M. D. F. (2014). Development of Children's Personality: The role of early childhood education. Psicologia em Estudo, 19(4), <https://www.scielo.br/j/pe/a/Q39MGD7HSyJ4XsSQdLLJgw/?lang=en>

⁹ Ligji mbi edukimin e hershem 2006

¹⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës sipas grup moshes 0-6, regjistrimi I vitit 2024

në këtë nivel të edukimit. Në këtë dokument, ndër të tjera thuhet se duhet të bëhen përpjekje për të siguruar një bazë më të mirë për rritjen e potencialit tek fëmijët. Niveli EFH është i rëndësishëm sidomos duke marrë parasysh pengesat që kanë gratë e reja për të hyrë në tregun e punës.¹¹ Vlen të ceket se sipas statistikave të fundit numri i fëmijëve të inkuadruar në EFH, të moshës 0-6 vjeç është vetëm 21%.¹²

Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (tutje MASHT) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar për të gjitha nivelet e EFH-së. MASHT themelon të gjitha IP Publike si dhe licencon në bazë periodike IP Private, IP me bazë në komunitet dhe IP me partneritet publiko-privat. Kjo përgjegjësi është gjithëpërfshirëse edhe në aspektin e mbikëqyrjes së të gjitha institucioneve parashkollore e që i takojnë moshës 0-5 vjeç.

Sipas të dhënave nga MASHT, numri i IP-ve që aktualisht janë funksionale është 245, prej të cilave 65 IP kanë statusin publik, 170 është numri i IP Private të licencuara, kurse 10 të tjera i takojnë kategorisë së IP-ve me bazë në komunitet dhe me partneritet publiko privat.¹³

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka ndërmarrë këtë auditim për të vlerësuar mënyrën e funksionimit, licencimit dhe të mbikëqyrjes së IP-ve. Përmes tij, ZKA synon të ofroj informata dhe rekomandime për të ndihmuar të gjitha palët e interesit që të bëjnë përmirësime të nevojshme të procesit dhe ngritjen e cilësisë së edukimit dhe arsimit në fëmijërinë e hershme.

2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektiva e këtij auditimi është të vlerësojë organizimin e procesit të edukimit në fëmijërinë e hershme, kapacitetet dhe funksionimin e institucioneve parashkollore. Gjithashtu, auditimi synon të shqyrtojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e këtyre institucioneve nga palët përgjegjëse.

Synimi ynë kryesorë është të ofrojmë rekomandime të dobishme për përmirësimin e performancës së entiteteve përgjegjëse, me qëllim të sigurimit të mirëqenies, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirjes cilësore të fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme.

Pyetjet e auditimit

Pyetjet audituese janë të fokusuara në, shqyrtimin e hartimit të politikave institucionale për edukimin e hershëm, verifikimin e procedurave të licencimit dhe vlerësimin e mbikëqyrjes dhe monitorimi së Institucioneve Parashkollore. Në bazë të këtij sistemi, pyetjet audituese janë:

1. A ka arritur Ministria e Arsimit të vendos një proces efektiv të funksionimit dhe mbikëqyrjes së Institucioneve Parashkollore?

2. A ka arritur Ministria e Arsimit të siguroj procese të rregullta të licencimit të IP-ve?

¹¹ Raporti I Komisionit Evropian, për reformat në shtetet e Ballkanit perëndimorë, Raporti për Kosovën 2024, fq 16

¹² Agjencia e statistikave të Kosovës, regjistrimet e vitit 2024

¹³ Të dhënat e ofruara nga MASHT 2024, DAPU, data baza e institucioneve parashkollore në nivel vendi

3.A është realizuar me efektivitet monitorimi i Institucioneve Parashkollore për shërbimet e ofruara?

Pyetjet e auditimit janë formuluar në përputhje me fushëveprimin e auditimit duke përfshirë MASHTI-in si organ përgjegjës për hartimin e politikave, mbikëqyrjen, funksionalizimin dhe licencimin e institucioneve parashkollore. Në nivel lokal, auditimi përfshin komunat me numër më të madh të institucioneve parashkollore si Gjakovën, Prishtinën dhe e Prizrenin, me fokus në menaxhimin dhe monitorimin nga ana e qeverisjes lokale. Fushëveprimi i këtij auditimi mbulon periudhën 2022-2024. Për të vlerësuar efektin e shërbimeve të ofruara, është shqyrtuar një numër i institucioneve parashkollore publike, private, me bazë në komunitet, si dhe publiko-private, të përzgjedhura në bazë të mostrës së auditimit.

Metodologjia dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në *Shtojcën 1*.

3 Gjetjet e auditimit

Niveli i Edukimit në Fëmijërinë e Hershme paraqet një proces kompleks të aktiviteteve ndërinstitucionale që i përkasin nivelit qendror dhe lokal të qeverisjes.

Menaxhimi, mbikëqyrja dhe monitorimi i institucioneve parashkollore bëhet sipas kategorisë dhe statusit që IP-të kanë:

- Institucionet parashkollore private, IP me bazë në komunitet¹⁴ dhe IP me partneritet publiko privat¹⁵ licencohen, monitorohen dhe mbikëqyren drejtpërdrejtë nga MASHTI, respektivisht Divizioni për EFH dhe Inspektorati i Arsimit. MASHTI, në bashkëpunim me komunat, gjithashtu ka të drejtë të angazhohet në investime të reja të IP publike.
- Institucionet parashkollore publike, themelohen përmes bashkëpunimit mes MASHTI-të dhe Komunave. MASHTI ka nën përgjegjësi mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të tyre përmes Inspektoratit të Arsimit. Mirëpo, planifikimi për zgjerim të kapaciteteve, menaxhimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i IP publike bie nën përgjegjësinë e komunave, respektivisht Drejtorive Komunale të Arsimit.

Më konkretisht, numri i përgjithshëm i IP-ve në mbarë Kosovën, për vitet 2022-2024, është 245. Prej tyre 170 janë IP Private, 65 IP Publike, 9 IP me bazë në komunitet si dhe 1 IP me partneritet publiko-privat.

Tabela 1: Numri i Institucioneve Parashkollore nëpër komunat e Kosovës

¹⁴ IP me baze ne komunitet perdoret si term per IP qe kane strukture te organizimit te bazuar ne keshillin drejtues, te prinderve dhe partnereve themelues.


¹⁵ IP me partneritet publiko privat- perdoret si term per IP te cilat themelohen me kapital te perzier te percaktuar me marrëveshje ndërmjet autoritetit publik dhe personit juridik

Pasqyra e institucioneve parashkollore sipas komunve, periudha 2022-2024								
Komuna	Institucionet parashkollore		Komuna	Institucionet parashkollore		Komuna	Institucionet parashkollore	
	IP Publike	IP tjera		IP Publike	IP tjera		IP Publike	IP tjera
Prishtinë	8	96	Podujevë	4	1	Deçan	/	/
Pejë	1	12	Kamenicë	1	/	Dragash	/	/
Prizren	2	5	Gjilan	4	3	Leposaviq	/	/
Gjakovë	8	9	Skënderaj	1	/	Shtërpc	/	/
Ferizaj	1	10	Glllogoc	3	3	Zubin Potok	/	/
Fushë Kosovë	1	19	Viti	1	/	Zveçan	/	/
Obiliq	1	/	Klinë	1	/	Novo Bërdë	/	/
Vushtrri	3	6	Istog	5	/	Mitrovicë e Veriut	/	/
Lipjan	5	6	Malishevë	2	/	Junik	/	/
Shtime	1	1	Rahovec	1	/	Ranillug	/	/
Suharekë	7	1	Kaçanik	1	/	Partesh	/	/
Graçanicë	/	3	Mamushë	1	/	Klllokot	/	/
Mitrovicë	1	5	Hani i Elezit	1	/			

Shtrirja e IP-ve në mbarë territorin e Kosovës, është paraqitur edhe në grafikun e mëposhtëm, që dëshmon për një numër të konsiderueshëm të IP-ve funksionale nëpër komuna, 13 prej të cilave nuk kanë asnjë IP. Vlen të ceket se këtu bëjnë pjesë komunat që në regjistrat e ministrisë nuk figurojnë të kenë funksionalizuar ndonjë IP publike apo private deri më tani dhe bëhet fjalë kryesisht për territorin e pjesës veriore të Republikës së Kosovës. Regjistrin e të gjitha institucioneve arsimore e mbajnë dhe e përditësojnë rregullisht autoritetet e MASHTI-it.¹⁶

Grafiku 1. Harta e Kosovës sipas shtrirjes gjeografike të Institucioneve Parashkollore.

¹⁶ UA nr.104/2020 Kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të institucioneve të arsimit para universitar, neni 6



Sipas të dhënave, komunat me numrin më të madh të IP-ve publike janë Gjakova dhe Prishtina, ndërsa Prizreni ka numrin më të ulët të IP-ve publike funksionale. Auditimi është fokusuar në këto tri komuna, pasi ato ofrojnë mundësi për analizë krahasuese dhe përdorim të metodave analitike për të gjitha kategoritë e IP-ve. Mostrat e auditimit janë përzgjedhur në bazë të kategorisë së IP-ve, kapacitetit dhe gjendjes teknike të objekteve si dhe sipas numrit krahasues të fëmijëve. Gjatë procesit të auditimit, janë shqyrtuar dokumentacionet e 26 IP-ve të përzgjedhura si mostra të auditimit. Numri i mostrave të përzgjedhura dhe i atyre që ka kaluar në vëzhgime është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 2: Numri i mostrave të auditimit sipas kategorive të IP-ve dhe numri i IP-ve në proces të vëzhgimeve audituese

IP publike	IP private	IP me partneritet publiko privat	IP me bazë në komunitet	Totali
Numri i mostrave sipas kategorive				
6	17	1	2	26
Numri mostrave që kanë kaluar në vëzhgim				
6	7	1	2	16

Sipas statistikave, në tri komunat që janë në fokus të auditimit – Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren numri total i fëmijëve të regjistruar në edukimin në fëmijërinë e hershme është 11,404 fëmijë. Bazuar në mostrat e përzgjedhura, në këtë auditim janë përfshirë IP-të ku kanë qenë të regjistruar 2,796 fëmijë.

Përshkrimi në detaje i sistemit për funksionimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e IP-ve është dhënë në *Shtojcën 2* të këtij raporti.

Më tutje kemi shpalosur të gjitha gjetjet e auditimit, duke u bazuar në aktivitetet, detyrat dhe objektivat që parashtrojnë ky nivel i edukimit.

3.1 Zhvillimi i aktiviteteve të deritanishme në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit

Sipas analizave të MASHTI-të për planifikimet strategjike të periudhës 2022-2026, sektori i EFH-së mbulohet me 11% të buxhetit total të arsimit. Burimet financiare që duhet të mbulojnë koston e përllogaritur prej 35,6 milion euro janë ato të buxhetit të shtetit (50-60%) dhe nga donacionet (10%). Mirëpo, mbulimi i buxhetit prej 30% supozohet të mbulohet nga fonde shtesë përmes buxhetit të shtetit dhe nga financimi i huaj.¹⁷

Për periudhën tre vjeçare të auditimit, MASHTI ka iniciuar investime kapitale për zgjerim të kapaciteteve ekzistuese të IP-ve në mbi 30 komuna të Kosovës. Sipas dokumentacionit dhe sqarimeve të ofruara, këto investime arrijnë një vlerë prej 7.6 milion euro për projektet e përfunduara dhe mbi 17 milion për projektet që ende janë në zhvillim.¹⁸

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe në pajtim me procedurat e komisionit themelues që funksionon në kuadër të ministrisë, janë themeluar, përkatësisht funksionalizuar, pesë objekte të reja në Komunën e Prizrenit, Suharekës, dhe të Rahovecit.¹⁹

MASHTI po ashtu ka pasur disa zhvillime të reja edhe në aspektin e aktiviteteve për EFH-të. Krahas ligjit të ri janë iniciuar edhe marrëveshjet të reja me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë. Për të përmbushur objektivat e parashtruara ligjore dhe të marrëveshjeve të reja, autoritetet ministrore kanë aktivizuar grupe të caktuara punuese. Më konkretisht, gjatë vitit 2023 është aktivizuar një grup punues për dizajnin e projektit të Bankës Botërore “Partneriteti për të nxënëit e hershëm - Fondi i Mirëbesimit me shumë donatorë”.²⁰ Po ashtu gjatë vitit 2023, janë zhvilluar hulumtime për kostot e kujdesit në fëmijërinë e hershme si dhe është hartuar raporti i fizibilitetit për rritje të kapaciteteve të reja. Bëhet fjalë për raportet “Nxjerrja e kostove të ofrimit të modaliteteve publike, private dhe të

¹⁷ Strategjia e Arsimit 2022-2026; Objektivi Strategjik 1 “ Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme duke siguruar mjedise të sigurta mbështetëse dhe nxitëse si dhe shërbime të integruara dhe cilësore”, Tabela 3, Buxheti i SA, 2022-2026 në vite.

¹⁸ Shtojca e investimeve të bëra nga ministria në bashkëpunim me donatorë

¹⁹ Sipas vendimeve të Komisionit të themelimit MASHT, Divizioni I infrastruktures, Ndërtimet e IP-ve në Komunat; Prizren, Suharekë dhe Rahovec- (Fshatrat Xërxë, Ratkoc dhe Krushë e madhe).

²⁰ Vendim i lëshuar nga MASHT, Dizajnimi i projektit për EFH ne bashkëpunim me Bankën Botërore, data 27.01.2023

partneriteteve publiko-private për edukim parashkollor në Republikën e Kosovës” dhe “Studimi i fizibilitetit për IP-të modulare 2023”, të realizuara në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë si Zyra e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë në Kosovë (UNICEF) dhe Banka Botërore.²¹ Zbatimi i projekteve me Bankën Botërore ka vazhduar edhe në vitin 2024 – 2025, ku hyn zbatimi i shpërndarjes së donacionit prej dy milion eurove për mbështetjen e pjesëmarrjes së fëmijëve të shtresave të cënueshme.²²

Disa hapa janë bërë edhe në aspektin e draftimit të programeve të reja pedagogjike për EFH-në. Sipas zyrtarëve përgjegjës të ministrisë, draft programi për EFH është një dokument që avancohet në këtë nivel të edukimit duke afirmuar zbatimin e metodave të reja pedagogjike dhe eliminuar gradualisht metodat që kanë shërbyer si referenca që nga periudha e pasluftës. Drafti i parë i këtij programi pedagogjik për edukimin në fëmijërinë e hershme tanimë është në fazën e pilotimit në IP publike dhe private.

Në nën-kapitujt e mëposhtëm kemi shpalosur gjetjet lidhur me aktivitetet e ministrisë në aspektin e funksionimit, mbikëqyrjes dhe licencimit të Institucioneve Parashkollore.

- **Pengesat në hartimin dhe aprovimin e udhëzuesve administrativë**

Autoritetet e ministrisë janë të obliguara të angazhohen në hartimin e dokumenteve ligjore gjashtë muaj pas aprovimit të ligjit. ²³*Autoritetet duhet të angazhohen në zhvillimin e politikave programore dhe krijimin e mundësive të reja gjithëpërfshirëse në EFH.*²⁴

Njëra ndër përgjegjësitë e MASHT-it është përcaktimi i infrastrukturës ligjore, primare dhe sekondare për edukimin e hershëm.

Pas hartimit të ligjit të ri për EFH, MASHTI ka emëruar dy grupe punuese për hartimin e projekt-udhëzimeve administrative, njërin në janar dhe tjetrin në dhjetor të vitit 2023. Gjatë vitit 2023, gjithashtu janë mbajtur tri punëtori, ndërsa gjatë vitit 2024 janë mbajtur 11 punëtori tjerë. Sipas zyrtarëve, angazhimet e grupit punues, kanë pasur të bëjnë me nxjerrjen e 15 akteve të reja normative, rishikimin e udhëzuesve të vjetër dhe integrimin e tyre në komponentë të reja dhe më të përshtatshme me ligjin e ri. Ne kemi konstatuar se tre udhëzues administrativë janë përgatitur dhe dorëzuar për miratim tek autoritetet e ministrisë.

Gjatë periudhës kohore nga miratimi i ligjit në vitin 2023 e deri në fillim të vitit 2025, është evidentuar mungesë e angazhimeve për vënien e këtij ligji në zbatim. Përgjatë kësaj periudhe, pavarësisht se tre udhëzues administrativë janë përgatitur dhe janë në pritje të procedurave përfundimtare në kabinetin qeveritar, asnjëri prej tyre nuk është miratuar deri në momentin e auditimit. Sipas zyrtarëve përgjegjës, arsyeja kryesore për vonesat është ngarkesa e lartë e punës në

²¹ Kosovo ECEC Report

²² Vendimi i lëshuar nga MASHTI, data 30.09.2024

²³ Ligji mbi edukimin e hershem 2023, Neni 38

²⁴ Strategjia e arsimit 2022-27

ministri, e cila ka tejkaluar kapacitetet aktuale të stafit për të trajtuar çështjet që lidhen me këtë segment të arsimit.

Vonesat në hartimin dhe miratimin e udhëzimeve administrative ka bërë që ligji i ri për EFH të mos zbatohet në praktikë. Si rezultat, institucionet parashkollore po vazhdojnë të funksionojnë sipas rregullave të vjetra të cilat nuk janë në harmoni me ligjin e miratuar në vitin 2023. Kjo ka krijuar paqartësi për mënyrën e licencimit dhe vlerësimit të këtyre institucioneve. Për më tepër, fakti që kriteret e licencimit nuk janë ndryshuar që nga viti 2016 tregon se pa miratimin e udhëzimeve të reja administrative, po vonohet edhe reforma e paraparë me ligjin e ri për këtë sektor të edukimit.

- **Organizimi i mbikëqyrjes dhe parregullsitë e identifikuara gjatë inspektimit të Institucioneve Parashkollore**

MASHT ushtron mbikëqyrjen e IP-ve përmes Inspektoratit të Arsimit. Zyrtarët inspektues të Sektorëve të Inspektoratit Arsimorë (SIA) janë kompetent për të vlerësuar, kontrolluar, këshilluar, informuar dhe raportuar për gjendjen e IP-ve. Mbikëqyrja e IP-ve ka për qëllim të siguroj që këto institucione të përmbushin standardet e kërkuara me kriteret e përcaktuara të MASHTI-t, përkatësisht të hartuara nga Divizioni për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (DEFH).²⁵

Inspektorati i Arsimit në kuadër të MASHT funksionon nëpërmjet shtatë Sektorëve të Inspektoratit të Arsimit (tutje SIA) në regjionet kryesore si Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë.

Në këto shtatë SIA janë të angazhuar 20 inspektorë të arsimit për mbikëqyrje dhe monitorim të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e edukimit qofshin ato publike dhe private. Këta inspektorë janë të shpërndarë në secilën prej SIA-ve, ku janë të angazhuar një udhëheqës dhe dy deri në katër zyrtarë të inspektimit.

Sipas ligjit në fuqi, inspektorati i arsimit (tutje IA) duhet të mbikëqyr të gjitha IP-të dhe lloji i inspektimeve që ndërmerren është:

- Inspektime të përgjithshme - administrative dhe pedagogjike;
- Inspektime tematike - sipas planifikimit, me kërkesë dhe të pa paralajmëruara, si dhe
- Inspektime emergjente - gjykuar sipas rastit të paraqitur.

Inspektorati i arsimit harton plane dhe raporte të përgjithshme vjetore, në të cilat planifikohet mbikëqyrja e IP-ve. Megjithatë, raportet vjetore përmbajnë vetëm të dhëna statistikore lidhur me numrin e inspektimeve të realizuara brenda vitit kalendarik, pa përfshirë analiza të detajuara mbi zbatimin dhe rezultatet e mbikëqyrjes së e IP-ve, çka kufizon transparencën dhe vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese.

Gjithashtu, inspektorati i arsimit nuk posedon rregullore të brendshme, akte nënligjore apo dokumente operative që do ta mundësonin një strukturim më të qartë të funksioneve dhe përgjegjësi të zyrtarëve inspektues. Mungesa më e theksuar identifikohet në aspektin e organizimit të stafit, përkatësisht në mungesën e Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të

²⁵ Ligji mbi inspektoratin e arsimit, 2018 & Ligji mbi EFH, 2023

Punës. Aktualisht, angazhimet e inspektorëve bazohen në përshkrimet e përgjithshëm të përcaktuara me ligjin për Inspektoratin e Arsimit (*Shih shtojca 3; Angazhimi i inspektorëve në SIA*), pa ndonjë ndarje funksionale sipas niveleve të arsimit.

Kjo situatë ka rezultuar në shpërndarje jo të balancuar të punës, duke ndikuar në aktivitete të ulëta inspektuese në regjionet e caktuara. Përveç tjerash, mungesa e ndarjes së profileve të zyrtarëve inspektues në përputhje me nivelet e arsimit mund të ndikojë në cilësinë e mbikëqyrjes.

Më shumë detaje për numrin e inspektimeve të IP-ve dhe karakteristikat tjera të Sektorëve Regjional Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren, janë dhënë më poshtë:


SIA Gjakovë, nuk posedon raportet e inspektimit për periudhën 2022/2024. Arsyeja kryesore për këtë është fakti që kjo zyrë rajonale nuk ka të angazhuar ndonjë zyrtarë përgjegjës si inspektor i arsimit. Si pasojë e mungesës së stafit të mjaftueshëm në nivel qendror, mbikëqyrja në këtë rajon është realizuar kohë pas kohe përmes angazhimit të përkohshëm të inspektorëve nga SIA Prizren.

Gjatë periudhës audituese 2022-2024, në rajonin e Gjakovës është realizuar vetëm një inspektim tematik, i ndërmarrë nga SIA Prizren me kërkesë nga DKA e Gjakovës. Kjo situatë tregon për një nivel të pamjaftueshëm të mbikëqyrjes së institucioneve parashkollore në këtë rajon, duke krijuar pasiguri dhe paqartësi lidhur me funksionimin, menaxhimin dhe zbatimin e standardeve në këto institucione.

SIA Prishtinë - Sipas të dhënave nga raportet vjetore inspektuese, SIA Prishtinë ka realizuar 24 inspektime gjatë vitit 2022, 21 inspektime në vitin 2023 dhe 14 inspektime në vitin 2024.

Mirëpo, vërehet një tendencë në rënie e numrit të inspektimeve përgjatë tri viteve të fundit, e cila mund të sinjalizojë sfida të vazhdueshme në kapacitetet organizative dhe operationale të kësaj zyre inspektuese. Kjo tendencë e uljes së numrit të inspektimeve rrezikon të ndikojë në nivelin e mbikëqyrjes së institucioneve arsimore në rajon, duke kufizuar mundësinë për identifikimin dhe adresimin në kohë të çështjeve që lidhen me cilësinë dhe ligjshmërinë në arsim.

Diagrami 1: Përqindja e inspektimeve SIA Prishtinë




Të dhënat e përgjithshme japin të kuptojmë se gjatë periudhës kohore 2022-2024, Sektori Regjional i Inspektimeve në Prishtinë ka arritur të mbulojë 30% të Institucioneve Parashkollore.

Karakteristikë e këtij sektori është se në vitin 2024 është ndërmarrë një inspektim i përbashkët me inspektoratin sanitarë dhe të punës në katër institucione parashkollore.

SIA Prizren - Sipas raporteve vjetore të inspektimit, SIA Prizren ka realizuar 31 inspektime në vitin 2022, 9 inspektime në vitin 2023 dhe 21 inspektime në vitin 2024. Të dhënat tregojnë për një rënie të ndjeshme të aktivitetit inspektues në vitin 2023, ndjekur nga një rritje e pjesshme në vitin pasues. Luhatjet në numrin e inspektimeve tregojnë mungesë konsistence në zbatimin e aktiviteteve inspektuese ndër vite.

Diagrami 2: Përqindja e inspektimeve SIA Prizren



Të dhënat e përgjithshme japin të kuptojmë se gjatë periudhës kohore 2022-2024, Sektori Regjional i Inspektimeve në Prizren ka arritur të mbulojë 31% të Institucioneve Parashkollore.

Vlen të ceket se këto inspektime në disa raste kanë qenë të përsëritura në të njëjtat IP kurse vërehet se ka pasur IP që nuk janë kontrolluar asnjëherë.

Gjatë analizimit të këtyre raporteve të inspektimeve, kemi vërejtur se SIA-të regjionale kanë hasur në IP private që funksionojnë pa licencë të vlefshme. Këto institucione, sipas legjislacionit dhe përgjegjësisë të MASHTI-të, janë të obliguara të licencohen dhe ri-licencohen në mënyrë periodike nga Divizioni për EFH. Funksionimi i IP-ve pa licencë jo vetëm që bie ndesh me kërkesat ligjore, por gjithashtu rrezikon sigurimin e standardeve të përcaktuara për cilësinë dhe sigurinë në arsimin parashkollor.

Në rastet kur inspektoratet regjionale identifikojnë institucione parashkollore që funksionojnë pa licencë, ndër hapat e parë që ndërmerren është shqiptimi i gjobës që arrin vlerën monetare 1000-2000€, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Në raste të përsëritjes së shkeljes, inspektorati i arsimit inicion procedura kundërvajtës dhe shqipton vendimet për mbylljen e institucioneve që vazhdojnë të operojnë në mënyrë të paligjshme. Këto masa synojnë të forcojnë zbatimin e ligjit dhe të parandalojnë funksionimin e institucioneve që cenojnë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve arsimore për fëmijët në moshë parashkollore.

Më poshtë janë shpalosur rezultatet e inspektimeve të kryera që paraqesin gjendjen e konstatuar nga inspektorët arsimorë gjatë punës së tyre në terren.

Tabela 3: Të dhënat nga rezultatet gjatë aktiviteteve inspektuese në terren

REZULTATET E INSPEKTIMEVE PER VITET 2022-2024						
	Numri i inspektimeve	Inspektime në IP te Licencuara	Raste të IP Private Pa licencë	Raste të IP Private që janë mbyllur	Numri i gjobave të shqiptuara	Numri i vendimeve per kundërvajtje
SIA GJAKOVË	1	1	/	/	/	/
SIA PRISHTINË	45	10	35	/	2	11
SIA PRIZREN	46	15	31	2	/	13

Të dhënat nga raportet vjetore të inspektimit 2022/24

Siç rezulton nga gjetjet e auditimit mungesa e inspektorëve ka ndikuar që gjendja në komunën e Gjakovës të mbetet e paqartë dhe pa mbikëqyrje të rregullt, çka e bën të pamundur vlerësimin e saktë të funksionimit të institucioneve parashkollore në këtë komunë. Ndërkohë, në dy komunat kryesore, Prishtinë dhe Prizren, gjatë periudhës 2022–2024 është evidentuar një numër i konsiderueshëm i institucioneve parashkollore që kanë operuar pa licencë të vlefshme. Në Komunën e Prishtinës, inspektorati ka shqiptuar 2 gjoba administrative dhe 11 vendime për kundërvajtje, kurse në Komunën e Prizrenit janë shqiptuar 13 vendime për kundërvajtje. Megjithatë, pavarësisht identifikimit të një numri të madh të IP private që funksionojnë pa licencë dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, në një pjesë të rasteve nuk është ndërmarrë asnjë veprim ndëshkues nga ana e inspektorëve. Mungesa e reagimit institucional në raste të tilla jo vetëm që dëmton integritetin e sistemit të licencimit, por gjithashtu nxit praktika të paligjshme që mund të cenojnë sigurinë, cilësinë dhe të drejtat e fëmijëve në moshë parashkollore.

Sipas deklaratave të inspektorëve, disa institucione parashkollore kanë dorëzuar kërkesën për licencim dhe janë në pritje të vendimit të ministrisë. Me konkretisht në komunën e Prishtinës, sipas tabelës, rezulton që nga 35 IP të identifikuar pa licence, 22 raste janë në pritje të vendimit të ministrisë por ende nuk kanë marrë përgjigje nga Divizioni për Edukimin e Hershëm në MASHTI-të. Kurse në komunën e Prizrenit nga 31 raste të identifikuar pa licence, 16 raste janë në pritje të vendimit të ministrisë. Për shkak pasigurisë lidhur me vendimin final të ministrisë, ndaj këtyre institucioneve nuk ndërmerren masa konkrete ndëshkuese. Shqiptimi i gjobave apo mbyllja e këtyre institucioneve, të cilat janë në pritje të licencës, krijon një situatë të pafavorshme për të gjitha palët e përfshira, veçanërisht për fëmijët dhe përfshirjen e tyre në edukim. Inspektorët theksojnë se, në mungesë të licencës, nuk mund të vlerësohet me saktësi nëse ambientet e këtyre institucioneve janë të përshtatshme për aktivitetin edukativ. Për këtë arsye, funksionimi i institucioneve parashkollore pa licencë konsiderohet si një pasojë e mangësive sistimore në procesin e licencimit. Vonesat në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për licencim kanë kontribuar në funksionimin e një numër të konsiderueshëm institucionesh parashkollore pa licencë të vlefshme. Kjo gjendje jo vetëm që ndikon në shërbimet e ofruara, por krijon rrezik për ushtrim të veprimtarisë së paregjistruar dhe ul efikasitetin e mekanizmave mbikëqyrës.

3.2 Procedurat e licencimit dhe monitorimit *Procedurat jo efikase të licencimit*

Autoritetet zyrtare të Ministrisë së Arsimit duhet të emërojnë komisionin e veçantë për licencimin e IP-ve. Zyrtarët e Komisioni për Licencim, nxjerrin vendime për licencim/ri licencim apo refuzim të kërkesave të paraqitura më së voni një muaj para fillimit të vitit shkollorë.²⁶

Në vitin 2024 MASHTI ka bërë një ri sistematizim të vendeve të punës, me ç' rast është funksionalizuar divizioni specifik për Edukim në Fëmijërinë e Hershme (tutje DEFH). Paraprakisht EFH ka pasur vetëm një përfaqësues në kuadër të Divizionit për Arsimin e Hershëm dhe Parashkollorë.

Në kuadër të DEFH, funksionon Komisioni për licencim, përgjegjës që të shqyrtoj kërkesat për licencimin e kategorive të ndryshme të IP-ve, siç janë IP private, IP publiko private dhe IP me bazë në komunitet.

Komisioni për Licencim përbëhet nga pesë anëtar profesional, përfaqësues të divizioneve të ndryshme të MASHT, ku rol të rëndësishëm ka zyrtari i infrastrukturës si përgjegjës për vlerësimin e kushteve infrastrukturore të objekteve. Komisioni aktivizohet dhe funksionon sipas nevojës dhe sipas kërkesave për licencim. Pas kërkesës për licencim, komisioni vlerëson gjendjen dhe aprovon apo refuzon kërkesën për licencim.

Kohëzgjatja e licencës së institucioneve parashkollore, ndryshon sipas stadit të veprimtarisë. Fillimisht lëshohet për një vit, kurse ri licencimet bëhen deri në tre vite të tjera varësisht nga vlerësimi i komisionit. Më konkretisht kohëzgjatja e licencave është një deri në tre vjet.

Vlen të ceket se ka dy lloje të licencave që aprovohen; licenca për grup-moshën e fëmijëve 9 muaj deri 6 vjet dhe licencat vetëm për grup-moshën 3 deri 6 vjet.

Sipas ligjit, llojet e institucioneve që aplikojnë për licencim apo ri licencim janë:

Institucionet private, që financohen dhe menaxhohen nga personat juridik apo fizik jashtë buxhetit shtetërorë;

Institucionet me bazë në komunitet, që ofrojnë shërbime të edukimit në fëmijërinë e hershme të organizuara dhe menaxhuara nga komuniteti në marrëveshje me komunën;

Institucionet me partneritet publiko privat, të cilat themelohen me kapital të përzier të përcaktuar me marrëveshje ndërmjet autoritetit publik dhe personit juridik.


Kemi vërejtur se institucionet parashkollore të cilat duhet të pajisen me një licencë për të ushtruar veprimtarinë e tyre, dorëzojnë kërkesat në Divizionin për Edukim të Fëmijërisë së Hershëm, gjatë tërë vitit pa ndonjë afat të caktuar kohor dhe kjo mënyrë e licencimit ndikon në aplikime të parregullta, numër të madh të kërkesave, si dhe vështirëson procesin e shqyrtimit të kërkesave për

²⁶ UA (MASHT) nr.15/2016 Licencimi dhe regjistrimi i Institucionit 16 edukativo-arsimorë parashkollore private, Neni 17, Dhënia e licencës

licencim. Sipas udhëzuesve administrativ licencimi duhet të bëhet së paku një muaj para fillimit të vitit shkollor.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri kërkesave për licencim krahasuar me numrin e IP-ve të licencuara për periudhën kohore 2022-2024.

Grafiku 2: Numri i kërkesave për licencim në krahasim me numrin e IP-ve të licencuara gjatë periudhës kohore 2022-2024, në mbarë Kosovën



Të dhënat nga Ministria e Arsimit, shkurt 2025

Gjatë periudhës 2022–2024 janë paraqitur mbi 300 kërkesa për licencim, prej të cilave vetëm 180 IP janë licencuar. Shumë prej kërkesave janë bartur nga viti në vit dhe sa ju përket shqyrtimit të tyre situata është e paqartë. Numri i kërkesave për licencim të regjistruara në data bazën e DEFH-së, nuk është në përputhje me numrin e institucioneve parashkollore të cilat janë licencuar. Kjo data bazë nuk ofron të dhëna për numrin e kërkesave të pa shqyrtuara dhe të bartura ndër vite.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se procesi i licencimit nuk përcakton afate kohore për shqyrtim dhe aprovim të licencave sipas udhëzimit administrativ²⁷ dhe nuk garanton trajtim të barabartë të kërkesave të palëve të interesuara private për të ushtruar veprimtarinë e zhvillimit të edukimit në fëmijërinë e hershme. Në analizat e mostrave janë identifikuar raste kur disa kërkesa janë trajtuar brenda një jave, ndërsa të tjera kanë mbetur në pritje prej 2-3 muaj deri në dy vite. Kjo ndodhë për shkak të mungesës së një sistemi efikas që trajton me kohë të gjitha kërkesat e pranura.

Më tutje, në rastet kur kërkesat për licencim të IP-ve refuzohen, aplikantët kanë të drejtë ligjore të ankohen duke ndjekur një procedurë të përcaktuar të ankesave. Ankesat shqyrtohen nga një komision i veçantë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të tyre. Analiza e të dhënave për periudhën 2022-2024 tregon se numri i ankesave të paraqitura për refuzimin e licencimit ka qenë i ulët. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar vetëm nga 2 deri në 5 raste të ankesave. Gjithashtu, nga

²⁷ UA nr.15/2016 Licencimi dhe regjistrimi i institucioneve edukativo-arsimore parashkollore private neni 17, pika 2

shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se asnjë nga vendimet për refuzim të licencimit nuk është ndryshuar apo anuluar nga komisioni shqyrtues. Për detaje lidhur me rezultatet e procedurave të ankesave, shihni tabelën e mëposhtme:

Tabela 4. Numri i ankesave dhe shqyrtimi i tyre gjatë periudhës 2022-2024

	Nr. i ankesave	Nr. i ankesave të shqyrtuara	Nr. i ankesave të aprovuara	Nr. i ankesave të refuzuara
2022	5	5	0	5
2023	2	2	0	2
2024	3	3	0	3

Burimi: Të dhënat nga komisioni i ankesave, MASHT

Siç shihet, numri i ankesave gjatë periudhës së auditimit ka qenë i ulët dhe procesi i ankesave nuk ka pasur ndonjë reflektim të rëndësishëm. Mirëpo numri i vogël i ankesave nuk paraqet ndonjë indikacion për mbarëvajtjen e procesit, sepse për shkak të vonesave në shqyrtimin e kërkesave, palët e interesuara nuk kanë pasur mundësi të paraqesin ankesë lidhur me vendimet e komisionit për licencim.

Mungesa e përcaktimit të afateve kohore për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për licencim ka ndikuar që procesi i licencimit të rezultojë joefikas. Sipas fakteve dhe analizave audituese konstatohet se kjo ka sjellë vonesa të mëdha në shqyrtimin e kërkesave, trajtim jo të barabartë të aplikuesve dhe pasiguri për institucionet që presin vendimet ministrore mbi funksionimin e tyre.

- **Mungesa e mekanizmave të monitorimit**

Zyrtarët e Divizionit të Edukimit të Hershëm (DEFH) janë përgjegjës që të bëjnë monitorim të rregullt dhe të vazhdueshëm për të gjitha IP të cilat licencohen si dhe të vlerësojnë kapacitetet dhe shërbimet e ofruara. DEFH duhet të përgatis raporte të monitorimit për punën e Institucioneve parashkollore pas përfundimit të vitit shkollorë.²⁸

Njëra ndër objektivat e DEFH, është monitorimi i vazhdueshëm i IP-ve të licencuara. Ky monitorim ka për qëllim të vlerësojë nëse IP-të e licencuara janë duke funksionuar sipas kriterëve të përcaktuar dhe nëse kanë realizuar sigurimin e kushteve dhe ambientin e përshtatshëm për grup moshat e caktuara.

Mirëpo, kemi vërejtur se DEFH nuk ka arritur që në fund të çdo viti shkollor të hartoj raporte të monitorimit për punën e IP-ve të licencuara për të vlerësuar zbatimin e kriterëve të licencimit.

Më poshtë kemi paraqitur një pasqyrë të gjendjes së IP-ve mostra të përzgjedhura për vëzhgime, për kategoritë e IP-ve të cilat licencohen nga ministria.

Tabela 5: Institucionet parashkollore dhe funksionimi i tyre sipas kriterëve të licencimit

²⁸ UA (MASHT) nr.15/2016 Licencimi dhe regjistrimi i Institucioneve edukativo-arsimore parashkollore private, Neni 17, Dhënia e licencës & Neni 28, Pika 6

Institucionet Parashkollore	Statusi	Lokacioni	Kapaciteti i fëmijëve (F) sipas licencës apo sipërfaqes se objektit	Numri aktual i fëmijëve (F) sipas vëzhgimeve	Të dhënat për objektin
IP1	Me bazë ne komunitet	Prishtinë	1435m ² (1435m ² /100f =14.5m ² për çdo fëmijë)	100 F	Objekt i komunës
IP2	Me bazë në komunitet	Prishtinë	2307m ² (2307m ² /196f=11.77m ² për çdo fëmijë)	196 F	Objekti i financiar nga IPA fondet
IP3	Me Partneritet publiko privat	Prishtinë	140 F	160 F	Objekt privat
IP4	Privat	Gjakovë	60 F	60 F	Objekt me qira
IP5	Privat	Gjakovë	70 F	54 F	Objekt i Kishës
IP6	Privat	Prishtinë	160 F	140 F	Objekt privat
IP7	Privat	Prishtinë	110 F	70 F	Objekt privat
IP8	Privat	Prishtinë	25 F	Nuk është në funksion	Objekt privat
IP9	Privat	Prizren	35 F	40 F	Objekt me qira
IP10	Privat	Prizren	120 F	120 F	Objekt i Kishës

Të dhënat nga MASHT dhe vëzhgimet e auditimit

Siç janë prezantuar në tabelë, janë tri kategori të IP-ve të cilat licencohen nga DEFH; IP me bazë në komunitet, IP me partneritet publiko privat dhe IP Privat. Infrastruktura e këtyre objekteve në raport me fëmijët është e përcaktuar sipas standardeve të matshme me sipërfaqen e objektit në dispozicion apo në rastet e tjera përcaktohet me vendimin për licencë të lëshuar nga ministria.

IP me bazë në komunitet bëjnë pranimin e fëmijëve në bazë të kapacitetit infrastrukturorë dhe sipërfaqes së objekteve. Sipas udhëzimit për normat dhe standardet e hapësirave të objekteve parashkollore, sipërfaqja për çdo fëmijë sillet rreth 3-6m² varësisht nga grup moshat. Sipas udhëzuesve të MASHT, numri prej 100-200 fëmijë aktualisht i regjistruar në këto dy IP është i lejueshëm për hapësirat që i kanë në dispozicion pasi që sipërfaqja e objekteve sillet 1400-2300m² dhe kjo hapësirë është e mjaftueshme për sistemimin e fëmijëve që këto IP kanë të pranuar.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme tejkallim të numrit të fëmijëve në raport me vendimin për licencë, e kemi vërejtur tek IP me partneritet publiko privat (IP3) në Prishtinë, ku është vërejtur një mbi-ngarkesë e numrit të fëmijëve aktualisht të regjistruar, gjë që tregon për 20 fëmijë më shumë se kapacitetet e lejuara.

Tek IP Private (IP8) në Prishtinë kemi vërejtur se ky institucion është mbyllur pa njoftuar zyrtarët dhe autoritetet përgjegjëse, edhe pse ka pas licencë pune edhe për një vit.

Një IP Private Prizren, (IP9) ka tejkalluar numrin e fëmijëve të regjistruar, duke pranuar pesë fëmijë më shumë se sa kapacitetet e lejuara me vendim për licencim. Gjithashtu, tek i njëjti kopsht kemi vërejtur se sipërfaqja e oborrit është e vogël dhe e betonuar, por është i pajisur me lodra për fëmijë.

Gjatë procesit të vëzhgimit në Gjakovë, (IP5) nuk kishte sipërfaqe të mjaftueshme të oborrit. I gjithë oborri ishte i betonuar dhe pa pajisje të lodrave për fëmijë. Oborri përdorej si parking për automjetet e stafit në vend që të jetë një zonë e sigurt dhe atraktiv për zhvillimin e fëmijëve. Shih foto në vijim;

Foto 1: Vëzhgimet në terren në njërin nga IP private në Gjakovë



Të gjitha këto parregullsi që kemi hasur gjatë vëzhgimit dhe krahasimit me standardet dhe kriteret e kërkuara nga DEFH, nuk i kemi hasur të monitoruara dhe as të evidentuara nga divizioni përgjegjës që ka për obligim në fund të çdo viti shkollorë të monitoroj të gjitha IP private të cilat i licencon.

Auditimi ka evidentuar se monitorimi i institucioneve private të licencuara nuk realizohet në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar nga DEFH. Sipas deklarimeve të zyrtarëve përgjegjës, mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe organizimit të brendshëm të punës paraqiten si faktorë kryesorë që kanë ndikuar në mosrealizimin e monitorimit të vazhdueshëm. Megjithatë, edhe pse ekzistojnë standardet e monitorimit, DEFH nuk e ka realizuar dhe dokumentuar monitorimin në mënyrë të rregullt. Gjatë auditimit, nuk është prezantuar ndonjë plan vjetor monitorimi, nuk ekzistojnë procedura standarde dhe as ndonjë sistem formal i raportimit që do të mundësonin ndjekjen sistematike të përmbushjes së kriterëve nga IP-të e licencuara.

Mungesa e këtyre mekanizmave e vështirëson identifikimin me kohë të mangësive në funksionimin e IP-ve dhe cenon efikasitetin e mbikëqyrjes institucionale në sektorin përkatës.

Më shumë detaje lidhur me rezultate të vëzhgimeve tona për të tri kategoritë e IP-ve të licencuara i kemi shpalosur në nënkapitujt e më poshtëm.

- **Rezultatet e vëzhgimeve në institucionet parashkollore me bazë në komunitet dhe me partneritet publiko privat**

IP me bazë në komunitet, janë të regjistruara si organizata jo qeveritare dhe funksionojnë sipas marrëveshjes me DKA. Ato kanë një sistem të organizimit të bazuar në përkrahje nga komuniteti, dhe menaxhohen nga anëtarët e Këshillit Drejtues. Ky këshill përbëhet nga udhëheqësi i IP-së, përfaqësues nga komuna dhe nga prindërit.²⁹

IP me partneritet Publiko-Privat, janë institucionet të cilat themelohen me kapital të përzier të përcaktuar me marrëveshje ndërmjet autoritetit publik dhe personit juridik.³⁰

Vlen të ceket se këto dy kategori të institucioneve parashkollore janë funksionale vetëm në Komunën e Prishtinës, që do të thotë se në mbarë Kosovën funksionojnë nëntë IP me bazë në komunitet dhe një IP me partneritet publiko privat. Ne kemi vëzhguar funksionimin e dy IP-ve me bazë në komunitet dhe një IP me partneritet publiko privat.

Rezultatet e vëzhgimeve në këto dy kategori të IP-ve janë paraqitur më poshtë:

IP me bazë në komunitet “Botanika” funksionon në objektin e komunës së Prishtinës. Sistematizimi, organizimi dhe struktura e objektit janë të përshtatura sipas standardeve dhe grup-moshës së fëmijëve. Në këtë IP janë të regjistruar 100 fëmijë dhe 10 edukatore. Kjo IP ka licencë sipas sipërfaqes së objektit dhe është në përputhje me kriteret e licencimit. Furnizimi me ushqim bëhet nga kuzhina qendrore e Komunës. Institucioni e zbaton programin mësimor “Montesori” dhe “Regio Emilio”. Kjo IP ka sistem të organizimit të mbështetur në këshill të prindërve. Sistematizimi, organizimi dhe struktura e objektit është sipas standardeve dhe grup-moshës së fëmijëve. Sipas zyrtarëve, kërkesa për regjistrim të fëmijëve është shumë e lartë. *Për detajet shih Shtojcën 5, Rezultatet e vëzhgimeve të Institucioneve Parashkollore.*

²⁹ Marrëveshja mes DKA dhe IP Civërimat, 20.04.2022

³⁰ Ligji mbi edukimin e hershem 2023

Foto 2: IP me bazë në komunitet “Botanika” Prishtinë



Këndi i lodrave në hapësirën e gjelbëruar jashtë objektit

IP me bazë në komunitet “Cicërimat” është ndërtim i ri i realizuar nga fondet e IPA-së.³¹ Në këtë IP janë të regjistruar 196 fëmijë dhe 23 deri 26 edukatore. Sistematizimi, organizimi dhe struktura e objektit janë të përshtatura sipas standardeve dhe grup-moshës së fëmijëve. Furnizimi me ushqim bëhet nga kuzhina qendrore e Komunës. Në aspektin pedagogjik zbatohet programi mësimor nga MASHTI, metoda e edukimit “Montesori”³² si dhe janë në pilotim të draft-programit të ri të ministrisë.

³¹ Instrumenti Para Anetaresimit, Fondet e Komisionit Evropian

³² Metoda Montesori: Edukimi Montesori është një metodë mësimdhënieje e përqendruar te fëmijët e bazuar në besimin se fëmijët mund të mësojnë përmes përvojës së tyre dhe me ritmin e tyre. Ky model i mësimdhënies e konsideron fëmijën si forcën përcaktuese në edukimin e tyre, duke inkurajuar pavarësinë dhe të mësuarit praktik.
<https://www.wgu.edu/blog/montessori-learning2207.html>

Foto 3: IP me bazë në komunitet “Cicërimat” Prishtinë



Kuzhina gjatë kohës së shërbimit të drekës

IP me partneritet publiko privat “Fillesa”, funksionon në objekt privat, me sistem të organizimit P +1, përdhese dhe kati i parë. IP është e licencuar për 140 fëmijë, kurse aktualisht janë të regjistruar 160 fëmijë, me 18 edukatore. Ky tejkallim i numrit ka shkaktuar mbingarkesë. Objekti ka nevojë për zgjerim të kapaciteteve të brendshme kurse sipërfaqja e jashtme e oborrit është e mjaftueshme dhe e pajisur me lodra. Sipas stafit përgjegjës në listën e pritjes janë edhe 150 kërkesa për regjistrime meqë lokacioni i IP-së ndodhet në lagjen më të banuar të qytetit. Në aspektin pedagogjik, zbatohet programi mësimor “Montesori” dhe janë në pilotim të draft-programit të ri të MASHT. Për detaje shih shtojcën numër 5; Rezultatet e vëzhgimeve të institucioneve parashkollore.

Foto 4: IP me partneritet publiko privat “Fillesa”, Prishtinë



Hyrja e Institucionit Parashkollorë

- **Rezultatet e vëzhgimeve në institucionet parashkollore private**

Në aspektin e përgjithshëm IP-të Private funksionojnë në objekte me qira apo edhe të ndërtuara me vetëfinancim. Sipas menaxherëve, çmimet e regjistrimit të fëmijëve në këto IP kalkulojnë në bazë të kostove të objektit dhe shpenzimeve të tjera që bartë hapja e një institucioni parashkollorë. Drejtorët e këtyre IP-ve pohojnë se shërbimet e ofruar i nënshtrohen një konkurrence mjaftë të lartë

prandaj duhet bërë përpjekje që të arrijnë standardet e duhura. Kërkesat për regjistrim të fëmijëve po ashtu janë mjaftë të larta.

Vlen të ceket se nga kjo kategori e institucioneve parashkollore janë funksionale 170 IP për komunat e Kosovës dhe për nga numri më i madh i tyre prinë Komuna e Prishtinës. Ne kemi vëzhguar funksionimin e shtatë IP Private, në tri komuna fushëveprim të këtij auditimi; Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren.

Më poshtë, kemi paraqitur disa informata të përgjithshme për funksionimin e këtyre institucioneve.

Foto 5: IP Private (IP4), Gjakovë



Dhomë e qëndrimit ditorë ku zhvillohen aktivitetet rekreative

Ky Institucion Parashkollorë funksionon në objekt me qira. Numri i fëmijëve të regjistruar, është në përputhje me vendimin për licencim aktualisht janë të regjistruar 60 fëmijë dhe 10 edukatore. Objekti është i ndërtuar sipas sistemit P +1 që do të thotë përdhese dhe kati shtesë. Objekti është në gjendje të mirë dhe ka sipërfaqe të mjaftueshme të oborrit, të pajisur me lodra. Fëmijët janë të sistemuar sipas grup moshave dhe zbaton plan-programin e MASHT-it. *Për detaje shih shtojcën numër 5; Rezultatet e vëzhgimeve të institucioneve parashkollore.*


Foto 6; IP Private (IP6), Prishtinë

*Hapësirë ku zhvillohen aktivitetet rekreative*

Ky Institucion Parashkollorë funksionon në objekt të ndërtuar me vet financim, sistemi i organizimit është përdhese dhe një kat, ka sipërfaqe të mjaftueshme të oborrit të pajisur me lodra. Numri i fëmijëve të regjistruar është më i vogël se sa vendimi për licencim i cili është 160 fëmijë kurse aktualisht janë të regjistruar 140 fëmijë dhe 29 edukatore. Në përgjithësi, në krahasim me IP tjera private në vëzhgim ka nivelin më të lartë të standardeve. Kjo IP zbaton programin mësimor “Reggio Emilio”³³ si dhe programin bërthamë të MASHT-it. Për detaje shih shtojcën numër 5; Rezultatet e vëzhgimeve të institucioneve parashkollore.

³³ Qasja Reggio Emilia: është një filozofi edukative e bazuar në imazhin e një fëmije me potenciale të forta zhvillimi dhe një subjekt me të drejta, i cili mëson përmes qindra gjuhëve që u përkasin të gjithë qenieve njerëzore dhe rritet në marrëdhëniet me të tjerët; <https://www.reggiochildren.it/en/reggio-emilia-approach/>

Foto 7; IP Private (IP10), Prizren



Sistem i organizuar me qasje të lehtë për fëmijët me aftësi të kufizuara

Ky institucion parashkollorë, funksionon sipas sistemit P+1, ka laborator dhe atelie dhe një sistem organizuar mirë për aktivitete rekreative si dhe është i vetmi IP privat që ka strukturë të përshtatshme organizative brenda objektit për fëmijët me nevoja të veçanta. Numri i fëmijëve të regjistruar është 120 dhe është në përputhje me kapacitetet sipas vendimit për licencim. Në këtë IP janë gjithsej 8 edukatore. Objekti ka sipërfaqe të oborrit dhe të lodrave jashtë objektit. IP punon me plan program të MASHT-it, “Montesori” dhe “Reggio Emilio”. Për detaje shih shtojcën numër 5; Rezultatet e vëzhgimeve të institucioneve parashkollore.

3.3 Zhvillimi i kapaciteteve nëpër komuna dhe funksionimi i Institucioneve Parashkollore Publike

- Kapacitetet infrastrukturore dhe niveli i ulët i përfshirjes në sektorin publik

Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë për detyrë të sigurojnë një mjedis gjithëpërfshirës për parashkollorët brenda territorit të tyre.³⁴ Autoritetet zyrtare nga Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë për detyrë të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse për të gjithë fëmijët e moshës parashkollore të moshës 0.9muaj-6 vjeçare.³⁵


Pranimi i fëmijëve në nivel të edukimit parashkollor bëhet përmes shpalljes së konkurseve nga DKA-të. Konkursi për regjistrimin në të gjitha IP-të publike, zakonisht shpallet në muajin qershor të çdo viti kalendarik, kurse procedura e regjistrimit fillon në shtator, si vit i rregullt shkollor.

Përfshirja e fëmijëve në këtë nivel të edukimit në raport me statistikën e fëmijëve të kësaj moshe, në tri komunat, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

³⁴ Ligji për arsimin në komunat e Kosovës, L03/L-068, Neni 11

³⁵ Ligji për arsimin në komunat e Kosovës, L03/L-068, Neni 11

Grafiku 3: Numri i fëmijëve të moshës 0-5 vjeç dhe numri i fëmijëve të regjistruar në IP



Informatat nga Agjencia e Statistikave 2022-2024

Sipas grafikut, përfshirja në EFH është në nivel dy herë më të ulët se sa numri total i fëmijëve. Në Gjakovë pjesëmarrja e fëmijëve në IP është rreth 17%, në Prishtinë rreth 26% dhe në Prizren vetëm 5%. Edhe pse edukimi për moshat 0 - 5 vjeç e fëmijëve nuk është e obligueshme me ligj, përfshirja e këtyre grup moshave reflekton në çështje sociale, në mundësinë e rritjes së shanseve për punësimin e grave dhe edukimin e hershëm si bazë kryesore e avancimit të shoqërisë. Kemi konstatuar se kërkesat e larta për regjistrimin e fëmijëve në IP publike parashtrojnë domosdoshmërinë për zgjerimin e kapaciteteve.

Interesimi i prindërve për regjistrimin e fëmijëve të moshës 0-5 vjeç në IP publike është i lartë dhe një numër i madh i kërkesave për këto grup moshë mbetet në pritje. Kapacitetet publike për këto grup moshë gjegjësisht numri i IP publike në krahasim me IP të kategorive të tjera qëndron siç është paraqitur në tabelë;

Tabela 6; Numri i IP-ve, sipas formës së tyre të organizimit në tri komunat

Komunat	IP - Publike	IP - Private	IP - Me bazë në komunitet	IP - Me Partneritet Publiko-Privat
Gjakovë	8	9	/	/
Prishtinë	8	86	9	1
Prizren	2	5	/	/

Të dhënat nga DKA-të

Të dhënat tregojnë se numri i IP publike është gjithëherë më i ulët se sa IP private, kjo reflekton në nivelin e ulët të përfshirjes së fëmijëve të moshës 0.9-5 vjeç në EFH dhe është e theksuar sidomos në kryeqytet, ku dendësia e popullsisë është më e lartë.

Gjithashtu duhet të theksojmë se përfshirja e fëmijëve duke filluar nga mosha 0.9 muaj është obligim ligjorë për të gjitha IP-të publike.³⁶ Vlen të ceket se, sipas ligjit të punës, pushimi i lehonisë zgjat 12 muaj, mungesa e përkrahjes institucionale në kujdestarinë e fëmijëve pas periudhës së pushimit të lehonisë paraqet pengesë për vazhdimin e punës apo inkuadrimin e grave në tregun e punës.³⁷

Auditimi ka evidentuar se, ndonëse komunat Gjakovë dhe Prishtinë, kanë siguruar përfshirjen e të gjitha grup moshave të përcaktuara për arsimin e hershëm në IP publike, Komuna e Prizrenit nuk ka përfshirë fare fëmijët e moshës 0.9m-3 vjeç në IP-të publike.

Sipas zyrtarëve të DKA-së dhe menaxherëve të IP-së, inkuadrimi i këtyre grup moshave kërkon investime specifike infrastrukturore, staf profesional të kualifikuar dhe buxhet të konsiderueshëm për krijimin e kushteve adekuate. Pavarësisht arsytimit të theksuar nga DKA-ja, ky nivel i edukimit është realizuar në komunat tjera. Për më tepër, kërkesat e shumta nga prindërit dhe listat e gjata të fëmijëve në pritje dëshmojnë për nevojën reale dhe të menjëhershme për zgjerimin e kapaciteteve dhe shërbimeve në këtë nivel arsimor edhe në Komunën e Prizrenit. Mungesa e përfshirjes së kësaj grup moshe krijon pabarazi në qasjen ndaj edukimit të hershëm dhe cenon të drejtën e fëmijëve për shërbime të barabarta arsimore publike.

Në anën tjetër, çmimet në IP publike janë fikse dhe sillen nga 40-50€ në muaj, kurse çmimet për regjistrim të fëmijëve në IP private janë dukshëm më të larta, duke filluar nga 70 dhe shkojnë deri në 300€ në muaj (Shih shtojcën 5 për detajet e mostrave të auditimit). Kjo diferencë e madhe në kosto, e kombinuar me kapacitetet e kufizuara të IP-ve publike, ka kufizuar ndjeshëm qasjen e barabartë të familjeve në shërbimet publike të edukimit të hershëm. Si rrjedhojë, një pjesë e konsiderueshme e prindërve detyrohen të mbështeten në kujdesin informal nga familjarët. Për më tepër, në rastet kur mungojnë mundësitë financiare për të përballuar tarifat e IP-ve private dhe kur nuk ka mbështetje familjare, përkujdesja për fëmijët bie kryesisht mbi gratë. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në kufizimin e mundësive të tyre për punësim dhe pjesëmarrje në jetën ekonomike, duke thelluar pabarazitë gjinore dhe duke ndikuar negativisht në mirëqenien socio-ekonomike të familjeve.

- **Aktivitetet komunale për zgjerim të kapaciteteve të sektorit publik**

Kompetencat komunale përfshijnë identifikimin e nevojave, përcaktimin e çështjeve administrative-teknike, si dhe përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve në këtë nivel të edukimit.³⁸ Zyrtarët komunal duhet të bashkëpunojnë me menaxherët, të vlerësojnë nevojat, si dhe të përmbushin kërkesat për mbarëvajtjen e punës

³⁶ Udhëzim administrativ (MASHTI) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, Neni 2, Pika 2.1 & LIGJI NR. 08/L-153, 2023 Neni 4 pika 1.11

³⁷ Ligji I punës, Nr.03/212, 2010, Neni 49, Pushimi i lehonisë,

³⁸ LIGJI NR. 03/L-068, për arsimin në komunale Republikës së Kosovës, Neni 8; Kompetencat e Komunës;

së IP-ve.³⁹ Aktivitetet e qeverisjes komunale për zgjerim të kapaciteteve të EFH-së mund të zhvillohen në mënyrë autonome dhe të pavarur në secilën nga komunat.⁴⁰

Kompetencat komunale në ndërtimin e objekteve arsimore përfshijnë identifikimin e nevojave për ndërtimin e objekteve arsimore, përcaktimin e çështjeve administrative-teknike, si dhe realizimin e aktiviteteve të monitorimit. Edhe pse komunat kanë për obligim të angazhohen për përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve moshës 0-5 vjeç në këtë nivel të edukimit,⁴¹ ekziston një dallim i madhe në mes të kapaciteteve që aktualisht janë në dispozicion dhe numrit të fëmijëve të kësaj grup moshe në Kosovë. Sipas statistikave të numrit të përgjithshëm të fëmijëve 0-5 vjet në krahasim me numrin e fëmijëve të përfshirë në IP Publike, në tri komunat mostra, është si në vijim; përqindja e përfshirjes së fëmijëve në Komunën e Prishtinës është vetëm 8 %, në komunën e Gjakovës është 12 %, kurse në Prizren është vetëm 1.7%. Vlen të ceket se sipas dëshmive të auditimit, kërkesat për regjistrim janë shumë të larta.

Në sektorin privat për tri komunat, përfshirja e fëmijëve qëndron kështu; Në Komunën e Prishtinës janë përfshirë 17%, në Gjakovë 4.7% dhe në Prizren 3.4% gjithashtu edhe për këtë sektor sipas përgjegjësve ekziston një interesim i lartë për regjistrim. Zhvillim i këtij niveli të edukimit është i varur nga specifikat e komunës, gjendja e trashëguar më herët, kufizimet buxhetore, vendimet e ndërmarra dhe prioritetet e përcaktuara.

Zgjerimi i kapaciteteve në të tri komunat është paraqitur në tabelën e prezantuar më poshtë. Për sqarim, pasi që është fjala për investime kapitale të cilat realizohen në afat më të gjatë kohorë, kemi marrë në konsideratë vitet 2021-2025.

³⁹ Ligji mbi edukimin e hershëm dhe kompetencat komunale.

⁴⁰ Ligji mbi edukimin e hershëm dhe kompetencat komunale

⁴¹ LIGJI NR. 03/L-068, për arsimin në komunale Republikës së Kosovës, Neni 8; Kompetencat e Komunës; Intervista e zhvilluar me akte të shoqërisë civile " OJQ Ed Guards", 18.12.2024

Tabela 7: Zgjerimi i kapaciteteve teknike për EFH në komunitet; Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren

Planifikimi dhe zgjerimi i kapaciteteve në tre komuna								
Numri i IP-ve	Lokacioni	Burimi I financimit	Stadi i ndërtimit	Viti i funksionalizimit/ kërkesat nga DKA per ndërtime				
Periudha audituese				<2021	2022	2023	2024	2025>
DKA Gjakovë								
1	Fshati Korenicë	MASHTI	Renovime të përfunduara	√				
2	Fshati Shishmon	MASHTI	Renovime të përfunduara	√				
3	Lagja "Sadik Pozhegu"	MASHTI	Objekt i adoptuar			√		
4	Fshati Cërmjan	MASHTI	Objekt i adoptuar			√		
5	Lagja "Dardani"	MASHTI	Kanë përfunduar ndërtimet					√
DKA Prishtinë								
1	Lagjja "Dardania"	DKA-Donacione	Kanë përfunduar ndërtimet					√
3	Lagjja "Shpëtim Robaj"	DKA-Donacione	Pritet të fillohet ndërtimi					√
4	Lagjja "Kolovica e vjetër"	DKA-Donacione	Pritet të fillohet ndërtimi					√
5	Lagjja "Pejton"	DKA	Renovime të përfunduara				√	
6	Lagjja "Kodra e diellit"	DKA	Renovime të përfunduara				√	
7	Lagjja "Fehmi Agani"	DKA	Renovime të përfunduara				√	
8	Lagjja "Kodra e diellit"	DKA	Renovime të përfunduara				√	
9	Lagjja "Ulipana"	DKA	Renovime të përfunduara				√	
10	Lagjja "George Bush"	DKA	Renovime të përfunduara				√	
DKA Prizren								
1	Lagjja "11 Maji"	DKA	Funksionale	√				
2	Lagjja "Bajram Curri"	DKA-MAPL	Funksionale				√	
3	Lagjja "Dardania"	MASHTI	Në ndërtim					√
4	Lagjja "Tusus"	DKA	Në ndërtim					√

Të dhënat nga DKA-të Gjakovë, Prishtinë, Prizren

Siç shihet, gjatë kësaj periudhe kohore, në tri komunat janë bërë përpjekje për zhvillim të kapaciteteve për EFH, të cilat janë bërë përmes ndërtimeve të reja, adoptimit apo renovimit të objekteve ekzistuese. Mirëpo niveli i përfshirjes së fëmijëve mbetet mjaftë i ulët. Gjatë vitit aktual 2025 pritet që në Komunën e Prishtinës dhe Gjakovës të funksionalizohen edhe nga një IP publike, kurse në Komunën e Prizrenit dy të tjera janë ende në ndërtim.

Më poshtë janë shpalosur detajet për të arriturat, dobësitë dhe sfidat e DKA-ve në këtë drejtim.

- **Drejtoria Komunale e Arsimit Gjakovë ka pasur progres në aspektin e zgjerimit të kapaciteteve të Institucioneve Parashkollore**

Komuna e Gjakovës ka bërë investime dhe renovime apo adoptim të dy objekteve publike, ku ka sistemuar rreth 600 fëmijë të grup moshës 0-5 vjeç.

Sipas autoriteteve të komunës së shpejti pritet që fëmijët e sistemuar në objektin e vjetër “ Ganimete Tërbeshi - Komon” ku ka mbingarkesë dhe kushte më të pavolitshme se sa në objektet tjera të kësaj IP-je të barten në objekt të ri. Vlen të ceket se sipas analizave të paraqitura më lartë, edhe pse ka pasur zgjerim të kapaciteteve, kërkesa për institucione parashkollore publike vazhdon të mbetet e lartë dhe është e rëndësishme që komuna të vazhdojë angazhimet për përmbushjen e nevojave të reja.

- **Drejtoria Komunale e Arsimit Prishtinë nuk ka progres të mjaftueshëm në zgjerim të kapaciteteve sipas nevojave**

Komuna e Prishtinës ka bërë disa investime të reja dhe renovime të objekteve të vjetra siç shihet në tabelën 5. Vlen të ceket se gjatë vitit 2024 kanë përfunduar punimet e një objekti të ri që pritet të vihet në funksion në vitin aktual 2025. Gjithashtu DKA e Prishtinës i ka të përfunduara të gjitha procedurat për fillimin e ndërtimit edhe të dy projekteve të reja. Për këto projekte DKA përveç që ka siguruar lokacionin, ka arritur edhe identifikimin e parcelës dhe pëlqimit urbanistik, si dhe për investimet e nevojshme është siguruar zotimi nga MASHT.

Në vitin 2024 janë përfunduar renovimet e gjashtë objekteve në lokacione të ndryshme të Prishtinës. Mirëpo edhe pse DKA Prishtinë ka pasur një plan zhvillimorë të arsimit për vitet 2018-2022, nuk ka vazhduar të përgatisë planin zhvillimorë të arsimit për vitet në vijim 2022-2025. Ndërtimet e reja janë ndërmarr në bazë të vendimeve momentale dhe jo të një analize të nevojave apo të planifikimit strategjik.

Deklarimet nga zyrtarët e nivelit qendrorë dhe lokal se ndërtimet nuk po realizohen për shkak se nuk janë identifikuar lokacionet, në mungesë të një analize konkrete nga DKA, nuk mund të verifikohen, prandaj shkaktar i këtij stagnimi në kryeqytet mund të jetë edhe mungesa e një plani të hartuar specifik se ku mund të fillojnë ndërtimet e reja. Mbingarkesa në IP publike vazhdon të vështirësojë funksionimin dhe zhvillimin e këtij niveli të arsimit dhe kjo parashtrohet nevojën urgjente që komuna patjetër të hartojë planin zhvillimorë për vitet e ardhshme, ashtu siç ka hartuar një plan zhvillimorë për vitet 2018-2022. Kjo do të ndihmonte konfirmimin e qartë për mundësitë e lokacioneve apo shqyrtimin e mundësive tjera se si do të rriten kapacitetet e domosdoshme në kryeqytet.

Mungesa e planifikimit strategjik për zgjerim të kapaciteteve rrit rrezikun për investime të paqëndrueshme, rritje të shpenzimeve dhe mosrealizim të objektivave afatgjata të zhvillimit të këtij niveli të edukimit në kryeqytet.

- **Drejtoria Komunale e Arsimit Prizren nuk ka progres të mjaftueshëm për përfshirje dhe zgjerim të kapaciteteve sipas nevojave**

DKA Komunale duhet të dorëzoj në Ministri të Arsimit propozimet për themelimin e institucioneve parashkollore publike, së paku tre muaj para fillimit të punës së institucionit përkatës.⁴² Çdo IP Publike duhet të ketë kodin e vet buxhetorë dhe numrin unik identifikues për menaxhimin e çështjeve financiare.⁴³

Komuna e Prizrenit deri në vitin 2010 ka pasur funksionale një IP publike me emrin “Yllkat”, e cila është dhënë me koncesion, gjë e cila është e lejuar për komunat me ligjin për partneritet publiko privat dhe koncesionet në infrastrukturë.⁴⁴ Më pas kjo IP ka kaluar nën shfrytëzim të autoritetit kontraktues dhe vazhdon të funksionoj si institucion edukativ arsimorë por jo për edukimin parashkollore.

Mungesa e plotë e këtij niveli të edukimit në sektorin publik është plotësuar me hapjen e një institucionit të ri për parashkollore, në vitin 2021/2022, në lagjen “11 Maj”, emëruar si IP “Zambaku”. Një trend i zhvillimit të ndërtimeve të reja në Prizren ka vazhduar dhe në vitin 2023 duke hapur edhe një IP Publike në lagjen “Bajram Curri”, kurse shumë shpejt pritet që kjo DKA të bëjë themelimin edhe të dy ndërtimeve të reja, në lagjet “Dardania” dhe “Tusus” të Prizrenit.

IP e hapur në lagjen Bajram Curri është funksionalizuar në shtator të vitit 2024, mirëpo është vërtetuar se DKA Prizren nuk ka arritur të përfundoj procedurat e plota të emërimit të IP publike të themeluar në këtë vit. Kjo procedurë është përcjellë nga DKA në autoritetet e ministrisë, mirëpo emërimi i këtij institucioni nuk ka përfunduar ende. Sipas zyrtarëve, mos përfundimi i procedurave deri në emërim të IP-së publike mund të ketë ndodhur për shkak të çështjeve teknike të udhëhequra nga ministria.

Vonesat në përfundimin e të gjitha procedurave administrative për funksionalizimin e institucioneve parashkollore reflektojnë në menaxhimin e aktiviteteve të përditshme të IP-së. Kjo çështje jo vetëm se paraqet rrezikun e mos evidentimit të IP-së në të gjitha instancat, por si pasojë mund të ketë edhe ndërlikime dhe paqartësi për menaxhimin e fondeve buxhetore.

⁴² Ligji për arsimin në komunat e RK-së, neni 5, Raportimi nga qeverisja lokale në MASHT

⁴³ Udhëzuesi administrative N 104 Per kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të Institucioneve Arsimore , fq 3, Neni 2 Perkufizimet,

⁴⁴ Ligji Nr. 03/L-090, mbi partneritetet publiko private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre

3.4 Menaxhimi i Institucioneve Parashkollore Publike nga Drejtoritë Komunale të Arsimit

- Mangësi në përcjelljen e vazhdueshme të aktiviteteve dhe të funksionimit të Institucioneve Publike

Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë për detyrë të monitorojnë në baza periodike IP-të Publike me qëllim të sigurimit të një mjedisi adekuat.⁴⁵ Kompetencat e komunës përfshijnë menaxhimin, hartimin e rregulloreve për zhvillimin e procesit edukativ, furnizimin e IP-ve dhe realizimin e të gjitha aktiviteteve që parashtrohen për funksionimin e rregullt të IP-ve Publike.⁴⁶

Në mënyrë që IP-të në vazhdimësi të kenë një ambient të përshtatshëm edukativ, është e rëndësishme që nga ana e DKA-ve të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i tyre. Monitorimi bëhet me qëllim të përcjelljes së realizimit të aktiviteteve të përditshme të Institucioneve Parashkollore. Mënyra se si është kryer procesi i monitorimit DKA-IP, në të tri komunat, është paraqitur në vazhdim:

Në **DKA Gjakovë**, institucionet parashkollore publike monitorohen së paku një herë në vit. Zyrtarët përgjegjës të DKA-së në fillim të vitit shkollor njoftojnë drejtorët e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve se do të jenë në monitorim nga drejtoria komunale e arsimit. Pas çdo vizite monitorimi, zyrtarët e DKA-së hartojnë raportin me përshkrim të gjendjes dhe rekomandimeve të dhëna për përmirësim. Përveç monitorimit që bëhet nga ana e zyrtarëve përgjegjës të arsimit, drejtori i përgjithshëm i IP-së çdo muaj përgatit raporte pune dhe i dërgon në DKA.

Vlen të ceket se kjo komunë e ka një sistem të centralizuar të funksionimit të IP-ve, që do të thotë se të gjitha IP-të janë të organizuara nga qendra e IP-së Ganimete Tërbeshi. Drejtori i IP “Ganimete Tërbeshi” bën monitorimin e vazhdueshëm dhe dorëzon sipas kërkesës së DKA-së raportet në mënyrë periodike, më konkretisht çdo muaj.

DKA Gjakovë në vitin 2017 ka hartuar një rregullore për organizimin e edukimit dhe arsimit në të gjitha institucionet edukative arsimore, ku është përfshirë niveli i edukimit parashkollorë, si dhe ka emëruar zyrtarin përgjegjës për hartimin e politikave për këtë nivel të edukimit.

Në **DKA Prizren**, kanë angazhuar ekspertë të jashtëm për të bërë një vlerësim të detajuar të të gjitha institucioneve arsimore për vitin shkollor 2024-2025, përfshirë edhe IP-Zambaku. Ky vlerësim është përmbledhur në një raport progresiv dhe ka paraqitur gjendjen aktuale të IP-së, duke paraparë edhe përmirësimet që duhet bërë gjatë vitit në vijim 2025. Po ashtu procesi i monitorimit të IP-ve dëshmohej me një procesverbal për vizitën që e kanë bërë tek IP “Zambaku” në nëntor të vitit 2024. Sipas zyrtarëve përgjegjës, procesi i monitorimi kryesisht bëhet gjatë regjistrimit të fëmijëve dhe zgjidhjes së ankesave të prindërve rreth këtij procesi. Mirëpo, mungesa e përfshirjes së moshës 0-3 vjet nuk është evidentuar në asnjë nga raportet e monitorimit dhe vlerësimit të përpiluara nga DKA.

⁴⁵ Ligji për arsimin në komunat e Kosovës, L03/L-068, Neni 39

⁴⁶ LIGJI NR. 03/L-068, 2008 Për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës Neni 5 ; Kompetencat e Komunave në nivelet arsimore

Më tutje, kemi vërejtur se DKA Prizren nuk e ka të punësuar zyrtarin përgjegjës për IP dhe nuk ka përfshirë edukimin parashkollorë në rregulloren për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore.⁴⁷

Sipas zyrtarëve arsyjeja pse nuk është emëruar asnjë zyrtar për këtë kategori, është sepse nuk ka staf të mjaftueshëm dhe se ky nivel trajtohet në kuadër të niveleve tjera të arsimit dhe edukimit. Mungesa e zyrtarit kompetent për këtë nivel të edukimit ndikon në menaxhimin e këtij sektori në përputhje me nevojat, si dhe mund të ndikoj në angazhimet për plotësimin apo hartimin e rregulloreve për funksionimin e IP-ve.

Në **DKA Prishtinë**, mungon një sistem i qartë dhe efikas i vlerësimit dhe monitorimit të IP-ve. Sipas zyrtarëve përgjegjës, mungesa e monitorimit të institucioneve parashkollore publike, ka ndodhur për shkak se ata janë në kontakt të vazhdueshëm me këto institucione dhe nuk e kanë zbatuar si praktikë dokumentimin e këtij procesi. Kjo situatë krijon rrezikun që të mos identifikohen dhe adresohen me kohë problemet dhe vështirësitë e funksionimit të IP-ve.

DKA Prishtinë, po ashtu nuk ka përfshirë edhe nivelin e edukimit parashkollorë në rregulloren për arsim ku janë të përcaktuara rregullat për nivelin e mesëm të ulët dhe të lartë. Arsyjeja për këtë, rezulton të jetë ngase DKA ende është në proces të rishikimit të rregullores së përgjithshme për arsim.⁴⁸

Mungesa e një sistemi të strukturuar dhe të dokumentuar për përcjelljen e rregullt të IP-ve publike kufizon aftësinë e DKA-ve për të identifikuar, adresuar dhe parandaluar në kohë mangësitë në ofrimin e shërbimeve edukative. Më tutje, mungesa e rregulloreve reflekton negativisht në koordinimin e punës mes DKA-ve dhe IP-ve. Të gjitha këto, ndikojnë në cilësinë e edukimit të hershëm, në mirëqenien e fëmijëve dhe në sigurimin e një ambienti të përshtatshëm dhe të barabartë edukativ në të gjitha institucionet.

- **Detajet nga vëzhgimet e Institucioneve Parashkollore Publike**

Në këtë nën kapitull janë shpalosur detaje për vëzhgimet e IP Publike në tri komunat subjekt të këtij auditimi.

IP Publike “Ganimete Tërbeshi” në Gjakovë, ka strukturë të organizimi të ndërtuar në mënyrë hierarkike në tetë objekte. Organizimi bëhet përmes qendrës së IP-së që funksionon si IP amë dhe shtatë objekteve tjera të varura që menaxhohen nga një drejtor i përbashkët. Mirëpo, në secilin objekt/degë të institucioneve parashkollore publike është i emëruar një përgjegjës për menaxhimin e tyre. Gjithashtu, edhe furnizimi me ushqim përgatitet në çerdhen amë dhe pastaj shpërndahet në objektet tjera.

⁴⁷ Rregullore për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunes së Prizrenit 2023

⁴⁸ Rregullore për organizimin e punës në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, E mail sqarues, dt 13.03.2025

Vlen të ceket se komuna nga viti 2022, ka mundësuar përfshirjen e grup moshave 3-5 vjet, (me kohëzgjatje prej 180 minuta), nëpër vendbanimet rurale kudo ku ka pasur klasë të lira në shkolla por që nuk ka pasur IP funksionale.

Informatat dhe pamjet nga vëzhgimet e auditimit janë të fokusuara në dy objekte të IP “Ganimete Tërbeshi”; “Orize” dhe “Komon”.

IP “ Ganimete Tërbeshi - Orize” shërben si bazë qendrore për shtatë IP-të tjera brenda komunës së Gjakovës, IP ka të regjistruar 160 fëmijë dhe 17 edukatore. Furnizimi me ushqim bëhet në baza ditore nga tetë firma të cilat janë përzgjedhur me procedura të prokurimit. Në këtë IP janë të regjistruar 206 fëmijë.


Foto 8; IP Publike “Ganimete Tërbeshi – Orize”, nën menaxhimin e DKA Gjakovë



Sipërfaqja e oborrit ne objektin “Orize”, qendrën e IP Ganimete Tërbeshi”

IP “ Ganimete Tërbeshi -Komon” është objekti më i vjetër i këtij institucioni dhe prandaj edhe funksionon në kushte më të vështira. Kjo IP pritet të zhvendoset së shpejti në një objekt të ri. Aktualisht janë të regjistruar 64 fëmijë dhe janë të angazhuara 10 edukatore.

Foto 9; IP Publike “ Ganimete Tërbeshi-Komon” nën menaxhimin e DKA Gjakovë



Sipërfaqja e oborrit dhe këndi i lodrave

Në vijim janë paraqitur disa informata dhe pamjet nga vëzhgimet e auditimit të fokusuara në dy objekte të IP në Prishtinë ; “Gëzimi Ynë” dhe “Xixëllonjat”.

IP “Gëzimi ynë” në Prishtinë në kompleksin e vet përfshin katër objekte. Vetëm njëri nga katër objektet është rinovuar, tre të tjerat funksionojnë në kushte jo të mira. IP ka kapacitet për 400 fëmijë, por aktualisht janë të regjistruar 360 fëmijë, kurse numri i edukatoreve është 42. IP nuk ka rregullim të hapësirave të gjelbëruara dhe mungon mirëmbajtja e këndeve të lojërave.

Foto 10&11; IP Publike “Gëzimi ynë” nën menaxhimin e DKA Prishtinë



Pamja e njërit nga katër objektet dhe e sipërfaqet e këndeve për lojëra

IP “Xixëllonjat” në Prishtinë është objekt i rinovuar dhe zgjeruar në vitin 2024. Numri i fëmijëve në 2024 është rritur nga 130 në 230 fëmijë kurse janë të angazhuara 32 edukatore . IP është e pajisur me inventar plotësisht të ri, dhe ka standarde të larta të kuzhinës dhe tualeteve. Karakteristikë e kësaj IP-je, është se gjatë kohës së vëzhgimit tonë, është vërejtur se nuk ka pasur sistem të kontrollit dhe sigurisë sepse hyrje dalja ka qenë e lirë, pa monitorim nga stafi.

Foto 12: IP Publike “Xixëllonjat” nën menaxhimin e DKA Prishtinë



Dhomë e fjetjes për moshat 0-3 vjeç

Në vijim janë paraqitur disa informata dhe pamjet nga vëzhgimet e auditimit të fokusuara në dy objekte IP-ve Publike në Prizren; “Zambaku” dhe IP-së në lagjen “Bajram Curri”.

IP “Zambaku” në Prizren ka filluar të funksionoj në maj të vitit 2021. Fëmijët e regjistruar në këtë IP i takojnë grup-moshës 3-6 vjet. Në këtë IP janë të regjistruar 185 fëmijë dhe numri i edukatoreve është 20. Sipas menaxherit ka kërkesa të larta për regjistrim, konkretisht edhe 150 fëmijë janë në listë të pritjes.

Hapësirat e brendshme të IP-së dhe sipërfaqja e oborrit janë të mirëmbajtura dhe të pajisura jo vetëm me lodra por edhe me shpezë shtëpiake.

Foto 13: IP Publike “Zambaku” nën menaxhimin e DKA Prizren



Sallë rekreative ku zhvillohen aktivitetet edukative

IP “Bajram Curri” në Prizren, ka filluar të funksionoj në shtator 2024. Në këtë IP janë të regjistruar 190 fëmijë dhe janë të angazhuara 20 edukatore. Përfshirja e fëmijëve në këtë IP janë të grup-moshës 3-6 vjet. Hapësirat e brendshme janë në nivel shumë të mirë, kurse oborri ka sipërfaqe të mjaftueshme mirëpo ka nevojë për pajisje me lodra.

Foto 14: IP në lagjen “Bajram Curri” nën menaxhimin e DKA Prizren



Kuzhina ku shërbehet ushqimi

4 Konkluzionet

Rezultatet e auditimit tregojnë se pavarësisht iniciativave ligjore dhe përpjekjeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për të avancuar edukimin në fëmijërinë e hershme, sistemi aktual përballlet me sfida strukturore, menaxheriale dhe zbatuese. Ka mungesë të infrastrukturës ligjore sekondare, të mekanizmave funksionalë për monitorim dhe licencim. Në nivel lokal, përkundër disa përpftimeve në ndërtimin e objekteve dhe monitorim të pjesshëm, mungesa e planeve zhvillimore, rregulloreve të funksionimit dhe përfshirjes së plotë të grup moshave, e pengon funksionimin e qëndrueshëm dhe cilësor të institucioneve parashkollore.

Ministria e Arsimit nuk ka arritur të vendosë një proces efektiv për funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve parashkollore. Ndonëse është miratuar Ligji për Edukim në Fëmijërinë e Hershme në vitin 2023, zbatimi i tij ka ngecur për shkak të mungesës së legjislacionit sekondar. Po ashtu, Ministria nuk ka siguruar një proces të rregullt, të drejtë dhe të barabartë të licencimit të institucioneve parashkollore. Ka mungesë të mekanizmave administrativë për trajtimin në kohë të kërkesave për licencim dhe mungojnë afate të qarta për vendimmarrje. Kjo ka shkaktuar vonesa, pasiguri institucionale dhe funksionim të disa institucioneve parashkollore pa licencë. Raste të dokumentuara tregojnë se edhe pas dhënies së licencës, disa institucione nuk kanë përmbushur kushtet ligjore.

Inspektorati i Arsimit, si organ përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve parashkollore, ende nuk ka sistematizim të vendeve të punës. Sektorëve të Inspektoratit të Arsimit i mungojnë profilet sipas niveleve të arsimit dhe niveli i mbikëqyrjes është vazhdimisht në rënie. Si rrjedhojë, mungon pasqyra e qartë e gjendjes së institucioneve parashkollore të licencuara, numri i atyre që funksionojnë pa licencë, si dhe nuk evidentohen parregullsitë tjera që mund të shfaqen tek të gjitha kategoritë e institucioneve parashkollore.

Divizioni për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, përgjegjës për licencimin e institucioneve parashkollore, nuk ka siguruar mekanizma përmes një administrimi efikas dhe të barabartë të kërkesave. Mungesa e një monitorimi të rregullt dhe të detajuar të institucioneve të licencuara parashkollore ka pamundësuar identifikimin e problemeve dhe ofrimin e mundësive për përmirësimin e tyre. Kemi vërtetuar se disa institucionet parashkollore të licencuara nuk kanë respektuar vendimet e komisionit të licencimit, duke zhvilluar procesin e edukimit në kushte jo të volitshme.

Afati i papërcaktuar për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për licencim ka krijuar vonesa dhe sfida në menaxhim të procesit, duke ndikuar në funksionimin e institucioneve parashkollore private pa licencë, si dhe duke shkaktuar rreziqe dhe pasiguri si për ministrinë, për institucionet parashkollore në funksion, si dhe palët tjera të interesit. Kërkesat për licencim nuk janë trajtuar me kohë dhe sipas radhës së aplikimit. Funksionimi pa licencë për shkak të vonesës së shqyrtimit të kërkesave apo edhe ndërprerja e veprimtarisë së institucioneve parashkollore të licencuara pa njoftuar autoritetin përkatës, shkaktojnë pasiguri dhe vështirësi të menaxhimit dhe kontrollit institucional në të mirën e interesit publik.

Ndonëse rritja e nivelit të përfshirjes së të gjitha grup moshave në edukim është paraparë si obligim ligjorë dhe objektivë strategjike, zbatimi i saj ka hasur në pengesa nga ana e qeverisjes lokale. Më

konkretisht, në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren nuk janë përfshirë mosha 0-3 vjeç në institucionet parashkollore publike.

Në aspektin e zhvillimit të kapaciteteve ndërtimore, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë ka arritur të zgjeroj kapacitetet në pesë objekte të reja. Në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prishtinë, ka pasur ndërtime të reja dhe renovime në disa objekte, megjithatë kjo Drejtori nuk ka hartuar plan zhvillimor të arsimit që do të orientonte investimet e reja dhe të domosdoshme. Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren ka hapur dy institucione parashkollore të reja gjatë periudhës 2022-2024, por ka pasur pengesa në përfundimin e procedurave administrative të emërimit dhe funksionalizimin të plotë dhe me kohë të tyre.

Drejtorja Komunale e Arsimit Gjakovë ka vendosur një praktikë të rregullt monitorimi vjetor, të mbështetur me raporte të dokumentuara dhe rekomandime konkrete, si dhe me raportim periodik nga drejtuesit e institucioneve parashkollore. Drejtoria Komunale e Arsimit Prizren ka ndërmarrë hapa drejt vlerësimit të gjendjes aktuale përmes angazhimit të ekspertëve të jashtëm dhe ka realizuar monitorime të herëpashershme. Përderisa, Drejtoria Komunale Prishtinë nuk ka vendosur një sistem të qartë dhe të dokumentuar për monitorimin e institucioneve parashkollore, gjë e cila kufizon aftësinë për të identifikuar dhe adresuar në kohë mangësitë ekzistuese.

5 Rekomandimet

Rekomandimet e mëposhtme kanë për qëllim që të përmirësojnë procesin e funksionimit, licencimit dhe të mbikëqyrjes së Institucioneve Parashkollore. Ato janë paraqitur dhe adresuar sipas shqyrtimit të procesit në entitetet përgjegjëse.

Rekomandojmë Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

- Të përshpejtojë procesin e hartimit të udhëzuesve administrativë si dhe të ndërmarrin aktivitetet e nevojshme për fillimin sa më të shpejtë të zbatimit të reformave të parapara për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme.
- Të forcohen mekanizmat për rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe raportimit për rastet e identifikuar të IP-ve pa licencë apo parregullsive tjera të shfaqura në të gjitha kategoritë. Në funksion të këtij qëllimi, inspektorati i arsimit të angazhohet në sistematizimin e vendeve të punës dhe shfrytëzimin sa më efikas të kapaciteteve ekzistuese në dispozicion.
- Të forcohet koordinimi dhe bashkëpunimi mes ministrisë dhe komunave për përfundimin me kohë të procedurave të themelimit, emërimit dhe regjistrimit të IP-ve në të gjitha instancat e nevojshme.
- Të përmirësojë menaxhimin e procesit të licencimit, të përcaktojë periudhat specifike kohore për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe të sigurojë që të gjitha kërkesat të shqyrtohen në mënyrë objektive për të rritur efikasitetin dhe besueshmërinë e procesit.
- Të vendosë një sistem për kontroll të rregullt të IP-ve të licencuara, për të verifikuar përputhshmërinë me kriteret ligjore dhe standardet e cilësisë, si dhe të ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj shkelësve.

Rekomandojmë Drejtoritë Komunale të Arsimit:

- Të angazhohen për monitorimin dhe menaxhimin efektiv të IP-ve në bazë të standardeve të përcaktuara me rregullore për organizimin e procesit edukativ të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme.
- Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë të hartoj planin zhvillimorë dhe të identifikoj lokacionet ku mund të bëhen investimet e reja në bazë të nevojave dhe të krijoj mekanizma të rregullt të monitorimit të IP publike.
- Drejtoria Komunale e Arsimit Prizren, të bëjë përpjekje që të përshpejtojë procedurat e themelimit dhe emërimit të institucioneve të reja parashkollore, si dhe të inkuadroj grup moshën 0-3 vjeçare në përputhje me kapacitetet dhe standardet përkatëse.

6 Shtojca 1. Fushëveprimi, metodologjia dhe përshkrimi i sistemit

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprim dhe fokus i këtij auditimi është Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), si institucion kryesorë përgjegjës për funksionalizimin dhe IP-ve. Në kuadër të kësaj ministrie përgjegjës për këtë nivel të edukimit është Divizioni për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe Inspektorati i Arsimit përfshirë shtatë njësitë regjionale inspektuese. Organizimi i mbikëqyrjes së IP-ve është testuar përmes shqyrtimit të aktiviteteve të Inspektoratit të Arsimit në tri komuna me numër më të madh të IP-ve Publike, siç janë Komuna e Gjakovës, Prishtinës dhe Prizrenit.

Më tutje, në fushëveprim janë përfshirë edhe Drejtoritë Komunale të Arsimit që kanë nën kompetencë menaxhimin e IP Publike. Edhe në këtë aspekt, janë marrë për bazë tri komunat e lartcekura të cilat janë testuar lidhur me angazhimin e tyre për koordinimin, organizimin dhe monitorimin e drejtpërdrejtë të IP-ve.

Shqyrtimi i efektit të funksionimit, licencimit dhe mbikëqyrjes është përqendruar në të gjitha kategoritë e IP-ve, siç janë; IP Publike, IP Private, IP Me partneritet publiko-private dhe IP Me bazë në komunitet.

Periudha kohore e fushëveprimit të këtij raporti të auditimit përfshinë vitet 2022 - 2024.

Metodologjia e auditimit

Në këtë auditim janë përdorur një varg teknikash dhe metodash për të siguruar dëshmi relevante, të besueshme dhe të mjaftueshme, të cilat na shpijnë në identifikimin e mangësive të proceseve respektivisht aktiviteteve.

Metodologjia e përdorur në këtë auditim është si në vijim:

- Analizimi i kornizës ligjore dhe rregullative lidhur me procesin e Licencimit të institucioneve parashkollore dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Analizimi i Strategjisë së Arsimit 2022-2026; për të shqyrtuar objektivat strategjike dhe problemet e konfirmuara nga hulumtimet strategjike;
- Analizimi i Planit të Veprimit për Strategjinë e Arsimit 2022-2026, për të shqyrtuar planifikimet dhe rezultatet e arriturat në fushën e EFH-së;
- Analizimi i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve; për të shqyrtuar të drejtat që dalin nga konventat ndërkombëtare dhe për të krahasuar progresin e EFH-së në Kosovë;
- Analizimi i Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjet (MASHTI);
- Aplikimi i testimeve audituese në DKA komunale, mbledhja e të dhënave statistikore, apo edhe analiza për trajtimin e çështjeve të tjera të veçanta.
- Analizimi i Raportit të Progresit për Kosovë
- Analizimi i Agjendës së Komisionit Evropian për Reformat në shtetet e Ballkanit Perëndimorë,

-
- Analizimi i marrëveshjeve nacionale dhe ndërkombëtare të Ministrisë së Arsimit për EFH
 - Analizimi i programeve pedagogjike të MASHTI
 - Analizimi i raporteve dhe hulumtimeve të ndryshme që ndërlidhen me funksionimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve parashkollore;
 - Analizimi i të dhënave/statistikave për numrin e institucioneve parashkollore të licencuara;
 - Analizimi i procesverbaleve/raporteve për inspektimet e bëra tek institucionet parashkollore;
 - Analizimi i dosjeve të përzgjedhura sipas metodave analitike, krahasuese dhe empirike.⁴⁹ për periudhën 2022-2024;
 - Zhvillimi i intervistave me zyrtarët e institucioneve përgjegjëse për të mbledhur informatat dhe sqaruar procesin
 - Zhvillimi i intervistave me drejtor dhe staf përgjegjës të Institucioneve Parashkollore, Private, Publike apo me status të kombinuar.
 - Vëzhgimi fizik i institucioneve parashkollore;
 - Dokumentacion tjetër relevant për punën tonë audituese.

⁴⁹ Evidencat empirike janë informata të mbledhura drejtpërdrejtë apo tërthorazi përmes observimit dhe testimit, apo eksperimentimit, që mund të përdoren për të konfirmuar teori, apo për të ndihmuar arsyetimin e një propozimi, në këtë rast rekomandimin auditues .


7 Shtojca 2. Përshkrimi i sistemit, pyetjet dhe kriteret e auditimit

Licencimi i institucioneve parashkollore dhe mbikëqyrja e tyre bëhet nga institucione të ndryshme si të nivelit qendror po ashtu edhe ato të nivelit lokal.

Në diagram kemi paraqitur rolin e palëve përgjegjëse të këtij spektri të edukimit dhe aktivitetet e tyre të vazhdueshme sipas entiteteve.

Diagrami 3: Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore

- Hartimi i politikave për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme



- Procedurat e themelimit dhe licencimit të Institucioneve Parashkollore



- Zhvillimi i kapaciteteve dhe niveli i përfshirjes në IP Publike



- Cilësia e shërbimeve në Institucionet Parashkollore



Sistemi i mbikëqyrjes dhe funksionalizimit të IP-se menaxhohet nga:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Informacionit, (MASHTI); përcakton politikat për funksionim, licencim dhe mbikëqyrje përmes **Divizionit për edukim në fëmijërinë e hershme (DEFH);** Roli i divizionit është monitorimi dhe raportimi për pjesën e dokumenteve përmbajtjesore apo standardet e zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Në rast të ndryshimit të kushteve të punës në

IEAPP, institucioni përkatës duhet t'i bëjë kërkesë MASHT-it për ndryshimin e kushteve të licencës. Në kuadër të këtij divizioni, ministria formon një komision të veçantë i cili do të shqyrtojë kërkesat për licencimin e IEAPP-ve dhe duhet të marrë vendim për dhënien apo mos dhënien e licencës. Sipas politikave të ministrisë, në rast të refuzimit të kërkesës për dhënien e licencës, pala së cilës i është refuzuar kërkesa, ka të drejtë që të bëjë ankesë. Ky divizion obligohet të mbajë një regjistër të të dhënave ku përfshihen të gjitha IEAPP e licencuara me të dhënat e tyre. Licenca e IEAPP aprovohet për afatin kohorë prej një deri në tre vite.

Inspektorati i Arsimit (IA); zhvillon procedura të mbikëqyrjes së të gjitha institucioneve parashkollore. Në kuadër të Inspektoratit të Arsimit, funksionojnë Zyra e drejtorit të përgjithshëm dhe shtatë (7) Sektorët e Inspektoratit të Arsimit (SIA-të), të cilët mbulojnë fushën e inspektimit në të gjitha institucionet edukative dhe arsimore të Republikës së Kosovës. Sektorët janë të vendosur në regjionet e; Prishtinës, Mitrovicës, Ferizajt, Pejës, Prizrenit, Gjilanit dhe Gjakovës

Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), kanë për detyrë të bëjnë monitorimin e Institucioneve Parashkollore Publike në mënyrë që të sigurojnë mbarëvajtjen e tyre. Ato janë përgjegjëse për themelimin dhe ndërtimin e objekteve arsimore parashkollore publike, dhënien e lejeve përfundimtare për vënie në përdorim të objektit dhe krijimin e kushteve normale për procesin e edukimit parashkollorë. DKA-të gjithashtu janë përgjegjëse për monitorimin e Institucioneve Parashkollore Publike për mbarëvajtjen e procesit të edukimit parashkollorë.

Institucionet parashkollore të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme; janë ambientet edukative arsimore që ofrojnë një game të gjerë të shërbimeve për zhvillimin e fëmijëve nga mosha zero deri në gjashtë vite. Ato sipas ligjit ndahen në këto kategori:

- Institucionet private të EFH, janë institucione që financohet dhe menaxhohet nga personat juridik apo fizik jashtë buxhetit shtetërorë.
- Institucionet e EFH me bazë në komunitet, janë institucione që ofrojnë shërbime të edukimit në fëmijërinë e hershme të organizuara dhe menaxhuara nga komuniteti në marrëveshje me komunën dhe në harmoni me standardet e aprovuara nga institucionet kompetente.
- Institucionet e EFH me partneritet publiko privat, janë institucionet të cilat themelohen me kapital të përzier të përcaktuar me marrëveshje ndërmjet autoritetit publik dhe personit juridik sipas legjislacionit në fuqi;
- Institucionet publike të EFH, janë institucione që financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe menaxhohet nga drejtoritë komunale të arsimit (DKA).

Pyetjet e auditimit

Për të iu përgjigjur objektivit të auditimit kemi parashtruar pyetjet dhe nën pyetjet e auditimit si në vijim:

1. A ka arritur ministria të vendos një proces efektiv të funksionimit dhe mbikëqyrjes së Institucioneve Parashkollore?

- 1.1 A janë zhvilluar politikat e duhura procedurale për funksionimin e IP - ve?
- 1.2 A është realizuar si duhet mbikëqyrja e të gjitha kategorive të IP- ve nga Inspektorati i Arsimit?

2. A ka arritur ministria që të siguroj procese të rregullta të licencimit të IP-ve?

- 2.1 A janë vendosur mekanizmat e duhur për licencimin e IP Private?
- 2.2 A janë vendosur afatet kohore për pranimin e kërkesave për licencim dhe a është siguruar zbatimi i tyre nga ana e divizioneve përkatëse?
- 2.3 A janë shqyrtuar dhe aprovuar kërkesat e subjekteve sipas kriterëve dhe kushteve të paracaktuara ?

3. A është realizuar me efektivitet monitorimi i Institucioneve Parashkollore për shërbimet e ofruara?

- 3.1 A janë shfrytëzuar në mënyrë efikase kapacitetet ekzistuese të IP Publike?
- 3.2 A është realizuar si duhet menaxhimi dhe monitorimi i institucioneve parashkollore publike nga Departamentet Komunale përkatëse?

Kriteret e auditimit

Kriteret e auditimit janë formuluar duke u bazuar në ligje, rregullore dhe objektiva të përcaktuara, si dhe duke u fokusuar në parime dhe praktika të mira. Zhvillimi i pyetjeve të këtij auditimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

Kriteri 1: Autoritetet e Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, janë të obliguara të angazhohen në hartimin e dokumenteve ligjore gjashtë muaj pas aprovimit të ligjit.⁵⁰ Autoritetet duhet të angazhohen në zhvillimin e politikave programore dhe krijimin e mundësive të reja gjithëpërfshirëse në EFH.⁵¹

Kriteri 2: Ministria e Arsimit, Shkencës , teknologjisë dhe Inovacionit ushtron mbikëqyrjen e IP-ve përmes Inspektoratit të Arsimit. Zyrtarët inspektues të Sektorëve të Inspektoratit Arsimorë (SIA) janë kompetent për të vlerësuar, kontrolluar, këshilluar, informuar dhe raportuar për gjendjen e IP-

⁵⁰ Ligji mbi edukimin e hershëm 2023, Neni 38

⁵¹ Strategjia e arsimit 2022-27

ve. Mbikëqyrja e IP-ve ka për qëllim të siguroj që këto institucione të përmbushin standardet e kërkuara me kriteret e përcaktuara të MASHTI-të, përkatësisht të hartuara nga Divizioni për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (DEFH).⁵²

Kriteri 3. Autoritetet zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit duhet të emërojnë komisionin e veçantë për licencimin e IP-ve. Zyrtarët e Komisioni për Licencim, nxjerrin vendime për licencim/ri licencim apo refuzim të kërkesave të paraqitura më së voni një muaj para fillimit të vitit shkollorë.⁵³

Kriteri 4: Zyrtarët e Divizionit të Edukimit të Hershëm (DEFH) janë përgjegjës që të bëjnë monitorim të rregullt dhe të vazhdueshëm për të gjitha IP të cilat licencohen si dhe të vlerësojnë kapacitetet dhe shërbimet e ofruara. DEFH duhet të përgatis raporte të monitorimit për punën e Institucioneve parashkollore pas përfundimit të vitit shkollorë.⁵⁴

Kriteri 5: Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të dorëzojnë në ministri propozimet për themelimin e institucioneve parashkollore publike, së paku tre muaj para fillimit të punës së institucionit përkatës.⁵⁵ Çdo IP Publike duhet të ketë kodin e vet buxhetorë dhe numrin unik identifikues për menaxhimin e çështjeve financiare.⁵⁶ Anëtarët e komisionit për licencim duhet të sigurojnë se IP-të përmbushin kushtet e domosdoshme sipas normave dhe standardeve për hapësirat e objekteve parashkollore, për të ofruar një mjedis të sigurt dhe cilësorë për fëmijët, gjithnjë duke përfshirë edhe aspektet sociale dhe pedagogjike.⁵⁷

Kriteri 6: Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë për detyrë të sigurojnë një mjedis gjithëpërfshirës për parashkollorët brenda territorit të tyre.⁵⁸ Autoritetet zyrtare nga Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë për detyrë të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse për të gjithë fëmijët e moshës parashkollore të moshës 0.9 muaj-6 vjeçare.⁵⁹

Kriteri 7: Kompetencat komunale përfshijnë identifikimin e nevojave, përcaktimin e çështjeve administrative-teknike, si dhe përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve në këtë nivel të edukimit.⁶⁰ Zyrtarët komunal duhet të bashkëpunojnë me menaxherët, të vlerësojnë nevojat, si dhe të përmbushin kërkesat për mbarëvajtjen e punës së IP-ve.⁶¹ Aktivitetet e qeverisjes komunale për

⁵² Ligji mbi inspektoratin e arsimit, 2018 & Ligji mbi EFH, 2013

⁵³ UA (MASHT) nr.15/2016 Licencimi dhe regjistrimi i Institucioneve edukativo-arsimore parashkollore private, Neni 17, Dhënia e licencës

⁵⁴ UA (MASHT) nr.15/2016 Licencimi dhe regjistrimi i Institucioneve edukativo-arsimore parashkollore private, Neni 17, Dhënia e licencës & Neni 28, Pika 6

⁵⁵ Ligji për arsimin në komunat e RK-së, neni 5, Raportimi nga qeverisja locale në MASHT

⁵⁶ Udhëzuesi administrative N 104 Per kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të Institucioneve Arsimore , fq 3, Neni 2 Perkufizimet,

⁵⁷ Udhëzues për norma dhe standard të objekteve parashkollore, MASHT 2022, fq.6

⁵⁸ Ligji për arsimin në komunat e Kosovës, L03/L-068, Neni 11

⁵⁹ Ligji për arsimin në komunat e Kosovës, L03/L-068, Neni 11

⁶⁰ LIGJI NR. 03/L-068, për arsimin në komunale Republikës së Kosovës, Neni 8; Kompetencat e Komunës;

⁶¹ Ligji mbi edukimin e hershëm dhe kompetencat komunale

zgjerim të kapaciteteve të EFH-së mund të zhvillohen në mënyrë autonome dhe të pavarur në secilën nga komunat.⁶² Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë për detyrë të monitorojnë në baza periodike IP-të Publike me qëllim të sigurimit të një mjedisi adekuat.⁶³ Kompetencat e komunës përfshijnë menaxhimin, hartimin e rregulloreve për zhvillimin e procesit edukativ, furnizimin e IP-ve dhe realizimin e të gjitha aktiviteteve që parashtrihen për funksionimin e rregullt të IP-ve Publike.⁶⁴

⁶² Ligji mbi edukimin e hershëm dhe kompetencat komunale.

⁶³ Ligji për arsimin në komunat e Kosovës, L03/L-068, Neni 11

⁶⁴ LIGJI NR. 03/L-068, 2008 Për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës Neni 5 ; Kompetencat e Komunave në nivelet arsimore

8 Shtojca 3. Investimet për zhvillim të kapaciteteve publike

Tabela 8: Ndërtimet e reja dhe ato në proces për periudhën kohore 2022-2024

Ndërtimet e reja 2022-2024			Ndërtimet në zhvillim 2022-24		
Nr	Lokacioni	Shuma e investimit	Nr	Lokacioni	Shuma e investimit
1	Vrellë-Istog	264,010.00 €	11	Istog	669,639.26 €
2	Suhareke	742,382.05 €	12	Klinë	560,330.50 €
3	Prizren	563,758.40 €	13	Komoran-Glllogoc	504,330.40 €
4	Prizren	799,272.72 €	14	Ferizaj	739,999.99 €
5	Dobërqaq – Gjilan	297,705.35 €	15	Pejë	947,619.66 €
6	Millosevë-Obiliq	569, 569.56€	16	Mitrovicë	488,000.00 €
7	Prishtinë	5,000,000.00 €	17	Prishtinë	743,347.74 €
8	Obiliq		18	Koretin-Kamenicë	741,013.95 €
9	Skenderaj		19	Gjakovë	758,892.49 €
10	Gjilan		20	Gjilan	710,995.62 €
			21	Podujevë	687,407.93 €
			22	Deçan	708,902.53 €
			23	F.Kosovë	1,282,282.28 €
			24	Batllavë-Podujevë	448,209.88 €
			25	F.Kosovë	415,659.59 €
			26	Prizren	743,246.84 €
			27	Godanc-Shtime	414,643.49 €
			28	Rahovec	540,364.80 €
			29	Gurakoc, Istog	713,437.39 €
			30	Viti	718,646.30 €
			31	Brodosanë, Dragash	1,082,569.56 €
			32	Kaçanik	1,096,043.96 €
			33	Malishevë	689,349.60 €
			34	Gjilan	895,429.07 €
	Gjithsejt;	7,667,128.52 €		Gjithsejt	17,300,362.83 €

Të dhënat nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit

9 Shtojca 4: Të dhëna për Inspektoratin e Arsimit

Tabela 9; Përbërja e stafit të Inspektoratit të Arsimit

Zyra qendrore e Inspektoratit të Arsimit	Profili	Numri i stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në IA - sektoret regjionale
	Jurist - Master	1	Inspektor te Arsimit	
	Pedagog	1	Inspektor te Arsimit	
	Gjuhe dhe letersi-Master	2	Inspektor te Arsimit	
Numri i stafit në Zyrën Qendrore të Inspektoratit të Arsimit				4
Sektori I Inspektoratit te Arsimit - Prishtinë	Profili	Numri i stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në regjionin e Prishtinës
	Pedagog - Master	1	Udhëheqës I SIA	
	Pedagog	1	Inspektor te Arsimit	
	Pedagog - Master	2	Inspektor te Arsimit	
	Gjuhe dhe letersi-Master	1	Inspektor te Arsimit	
	Biolog	1	Inspektor te Arsimit	
	Shkencat sportive	1	Inspektor te Arsimit	
Numri i stafit në SIA Prishtinë				7
Sektori I Inspektoratit te Arsimit - Mitrovicë	Profili	Numri i stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në regjionin e Mitrovicë
	Inxhinier - Master	1	Udhëheqës I SIA	
	Inxhinier- Gjeologji	1	Inspektor I Arsimit	
	Kimist-Master	1	Inspektor I Arsimit	
Numri i stafit në SIA Mitrovicë				3
Sektori I Inspektoratit te Arsimit - Pejë	Profili	Numri i stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në regjionin e Pejës
	Jurist	1	Udhëheqës I SIA	
	Pedagog-Master	2		
Numri i stafit në SIA Pejë				3
Sektori I Inspektoratit te Arsimit - Prizren	Profili	Numri i stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në regjionin e Prizrenit
	Inxhinier - Master	1	Udhëheqës I SIA	
	Pedagog -Master	2		
	Sociolog	1		
Numri i stafit në SIA Prizren				4
Sektori I Inspektoratit te Arsimit - Ferizaj	Profili	Numri i stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në regjionin e Ferizaj
	Inxhinier - Master	1	Udhëheqës I SIA	
Numri i stafit në SIA Ferizaj				1
Sektori I Inspektoratit te Arsimit - Gjiilan	Profili	Numri i stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në regjionin e Gjilanit

	Pedagog- Doktor i shkencave te historisë		Udhëheqës I SIA	
	Pedagog- Master psikologji		Inspektor te Arsimit	
	Gjuhe dhe letërsi / Jurist		Inspektor te Arsimit	
Numri i stafit në SIA Gjilan				3
Sektori I Inspektoratit te Arsimit - Gjakove	Profili	Numri I stafit	Titulli i punës	Numri i stafit në regjionin e Gjakovë
Numri i stafit në SIA Gjakovë				0

Tabela 10: Mostrat e auditimit / Numri i Inspektimeve 2022-2024

Numri I inspektimeve sipas mostrave					
Nr.	Institucioni Parashkollor	Lokacioni	IP te inspektuara gjate viteve 2022-2024		Lloji inspektimit I
			Po	Jo	
1	IP Publike	Prishtinë		x	
2	IP Publike	Prishtinë		x	
3	IP 1 (Me bazë në komunitet)	Prishtinë		x	
4	IP2 (Partneritet publiko-privat)	Prishtinë		x	
5	IP3 (IP Private)	Prishtinë		x	
6	IP4(IP Private)	Prishtinë		x	
7	IP5(IP Private)	Prishtinë		x	
8	IP6(IP Private)	Prishtinë		x	
9	IP7(IP Private)	Prishtinë		x	
10	IP8 (IP Me bazë në komunitet)	Prishtinë		x	
11	IP9 (IP Privat)	Prishtinë		x	
12	IP 10 (IP Privat)	Prishtinë		x	
13	IP 11 (IP Privat)	Prishtinë		x	
14	IP 12 (IP Privat)	Prishtinë		x	
15	IP Publike	Prizren	x		Verifikim
16	IP Publike	Prizren		x	
17	IP 13 (IP Privat)	Prizren	x		Verifikimi i ri licencimit
18	IP 14 (IP Privat)	Prizren		x	
19	IP 15 (IP Privat)	Prizren		x	
20	IP 16 (IP Privat)	Prizren		x	
21	IP 17 (IP Privat)	Prizren		x	
22	IP Publike	Gjakovë	x		Sipas kërkesës
23	IP Publike	Gjakovë		x	
24	IP 18 (IP Privat)	Gjakovë		x	

25	IP 19 (IP Privat)	Gjakovë		x	
26	IP 20 (IP Privat)	Gjakovë		x	

10 Shtojca 5 . Rezultatet e observimit të paraqitura në formë tabele

Tabela 11: Rezultatet e analizave nga vëzhgimet e auditimit

Gjendja e IP Publike sipas observimeve gjatë fazës së ekzekutimit									
IP Publike	Lokacioni	Kapaciteti i fëmijëve sipas licences	Numri aktual i fëmijëve	Çmimi i pagesës në €	Nr i edukatoreve	Programi pedagogjik	Të dhënat për objektin	Fëmijë me aftësi të kufizuara	Komente sipas gjendjes
1	"Ganimete Tërbeshe, Orize" - Gjakovë	162	160	45	17	Plan programi I MASHTI-it, 10 edukatore janë të përfshira në trajnim për kurrikulen e re.	Eshtë objekt i komunës	2 fëmijë me nevojë të veçanta	IP funksionon si qendër amë dhe si bazë për shtatë IP të tjera . Furnizimi me ushqim bëhet nga operatore privat. Ushqimi përgatitet në objektin bazë dhe pastaj shpërndahet në pikat tjera. Në këtë IP janë të përfshirë 22 fëmijë të minoriteteve.
2	"Ganimete Tërbeshe, Komon"-Gjakovë	/	71	45	10	Plan programi I MASHTI-it,	Eshtë objekt i komunës	Nuk ka fëmijë me nevojë të veçanta	Objekti është shumë i vjetër, daton nga vitet e '60-ta në gjendje jo të mirë. Për këtë objekt ka konteste lidhur me pronësinë dhe statusin e pronës, prandaj cështja e akomodimit pritet të zgjidhet me ndërtimin e ri që është në proces të funksionalizimit
3	Gëzim Ynë - Prishtinë	400	360	50	42	Plan-programi i MASHTI-it. Pedagogu dhe psikologu, angazhohen 2 herë	Kopshti i ka 4 objekte brenda të njëjtit oborr. Vetë njëri objekt është i renovuar, kurse 3 të tjerët nuk janë renovuar	14 fëmijë me nevojë të veçanta pa asistente për këtë kategori	Buxheti administrohet nga DKA, Ekipi pedagogjik i DKA-së, i trajton fëmijët me nevojë të veçanta vetëm në objektet e DKA-së dhe me miratimin e prindit. Sipas UA, fëmijët e shtresave sociale dhe me
4	Xixëllonjat - Prishtinë	230	230	50	32	13 grupe, me nga 2 edukatore.	DKA ka bërë renovimin e objektit në vitin 2024. Janë rritur kapacitetet, inventari është komplet i ri, toaletet dhe kuzhina në nivel të lartë.	3 fëmijë me nevojë të veçanta, pa asistente	Drejtoresha aktuale është në pozitë nga viti 2017. Në hyrje mungon sistemi i kontrollit dhe sigurisë, kjo pjesë nuk monitorohet nga stafi.
5	Zambaku - Prizren	200	185	50	20	PP MASHT, në pilotim, ka pasur trajnime për edukator, asistent për fëmijët me	Ndërtim i ri nga MASHTI dhe DKA	2 fëmijë me nevojë të veçanta	IP ka hapësirë të pershtatshme, dhe një pjesë të ndarë për rritjen e shpezeve. Furnizimi është një sfidë, si dhe ka kërkesa për përmirësim të renovimeve. Grup moshë me të rritur se 3-6 vjeç, ka grupin multietnik.
6	IP në lagjen Bajram Curri - Prizren	220	190	50	20	Kurrikula e MASHT, koordinatore, pedagog, asistent për nevojë të veçanta	Ndërtim i ri nga MASHTI dhe DKA	4 fëmijë me nevojë të veçanta	Ende s'ka emërtim, ka sfida në furnizime dhe përfaqësim. Janë në pritje për aktin e emërimit dhe të përfaqësimit në të gjitha nivelet. Ka startuar në 2024, kërkesat janë të larta, grup moshë 3-6 vjeç.

Gjendja e IP me partneritet publiko privat dhe me bazë në komunitet sipas vëzhgimeve të auditimit

IP Private dhe të kombinuara	Kapaciteti i fëmijëve sipas licencës	Numri aktual i fëmijëve	Çmimi i pagesës në €	Nr i edukatoreve	Programi pedagogjik	Të dhënat për objektin	Komentet sipas gjendjes së konstatuar
IP1 (Me bazë në komunitet) Prishtinë	1435m2 (1435m2/100f =14.5m2 për çdo fëmijë)	100	150 €	10	Montesori dhe Rexhio Emilio	Objekt i komunës, P	IP me bazë në komunitet që funksionon në objekt të komunës. Ka sistem të organizimit të mbështetur në këshill të prindërve. Sistematizimi, organizimi dhe struktura e objektit sipas standardeve dhe grup-moshës së fëmijëve.
IP2 (Me baze në komunitet) Prishtinë	2307m2 (2307m2/196f=11.77m2 për çdo fëmijë)	196	130 €	23 -26	Montesori dhe në pilotim të kurrikulës së re.	Objekti është i ndërtuar nga fondet IPA. P+1	IP e ndërtuar nga fondet e IPA-së. Sistematizimi, organizimi dhe struktura e objektit është sipas standardeve dhe grup-moshës së fëmijëve. IPA i ka mbështetur edhe me disa trajnime të stafit jashtë vendit. Trajnimet janë të domosdoshme.
IP3 (Me partneritet publiko privat) Prishtinë	140	160	80 €	18	MASHT dhe kurrikulë e re pilotim	Objekt privat P+1	IP në partneritet publiko privat mbështetur nga Komuna, me lokacion në një lagje të mbingarkuar. Ka 152 fëmijë në listë të pritjes për regjistrim. Për shkak të mbi ngarkesës me fëmijë, pronarët janë të interesuar të ndërtojnë edhe një IP tjetër.

Gjendja e IP privat sipas vëzhgimeve të auditimit						
IP Private	Kapaciteti i fëmijëve sipas licencës	Numri aktual i fëmijëve	Çmimi i pagesës në €	Nr i edukatorëve	Programi pedagogjik	Të dhënat për objektin
IP4 (IP privat) Gjakovë	60	60	120 €	10	Plan programi i MASHTI-it	Objekt, P+1
IP5 (IP privat) Gjakovë	70	54	80 €	4	Plan programi I MASHTI-it, Rexhio Emilio dhe Montessori	Objekt P+1
IP6 (IP privat) Prishtinë	160	140	300 €	29	Rexhio Emilio, kurrikula bërthamë e MASHTI-it	Objekt privat, P+1.
IP7 (IP privat) Prishtinë	110	70	220 €	13	Plan-programi i MASHTI-it, pilotim i kurrikulës së re	Objekt privat, P+1.
IP8 (IP privat) Prishtinë	25	/	90 €	/	/	Objekt privat P+1
IP9 (IP privat) Prizren	35	40	70 €	5	MASHTI	Objekt me qira, P+2
IP10 (IP privat) Prizren	120	120	120 €	8	Nga planprogrami I MASHTI-it; montessori regio emilio. Ka të	Objekt privat P+1,

11 Shtojca 6: Letër konfirmimet dhe komentet e entiteteve

Letër konfirmimi i palëve të audituara - Komuna e Gjakovës



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollë”,** dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Gjakovë, 29.07.2025

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollë”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Letër konfirmimi dhe komentet MASHTI-të



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja, Nauke,
Tehnologije i Inovacija/Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e performancës me temën: “Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore”,
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet, ndërsa komentet dhe dëshmitë i gjeni të bashkangjitur;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Arbërie Nagajev, Ministre përdetare

Data: 04.08.2025

Prishtinë





MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION

Auditimi i kryer: Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore

Dokumentit: Komentet nga MASHTI lidhur me draft raportin e auditimit

Te gjeturat	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mos pajtimit	Pikëpamja e ZKA-së
3.1. Zhvillimi i aktivitetëve të derianishme në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit		Koment: Numri i kufizuar i inspektorëve të arsimit ka qenë një sfidë e vazhdueshme në zbatimin efektiv të mbikëqyrjes institucionale në arsimin parashkollor. Kjo mangësi është reflektuar drejtpërdrejt në realizimin e inspektimeve të rregullta dhe gjithëpërfshirëse, duke rezultuar edhe me mbikëqyrje të pamjaftueshme.	Auditimi i performancës vlerëson shfrytëzimin efikas të burimeve në dispozicion. Lidhur me mungesën e stafit në SIA Gjakovë, raporti në mënyrë të qartë ka sqaruar se: “Si pasojë e mungesës së stafit të mjaftueshëm në nivel qendror, mbikëqyrja në këtë rajon është realizuar kohë pas kohe përmes angazhimit të përkohshëm të inspektorëve nga SIA Prizren.” (faqe 12) Ky sqarim është përfshirë për të theksuar lidhjen midis mungesës së resurseve njerëzore

			dhe nivelit të pamjaftueshëm të mbikëqyrjes në këtë rajon. Ndërkohë, detajet për inspektimet në SIA Prishtinë dhe Prizren janë dhënë vetëm për komunat e përfshira në fokusin e auditimit, dhe janë bazuar në informacionet dhe raportet e dorëzuara nga inspektorët e intervistuar.
3.2. Procedurat e licencimit dhe monitorimit	Koment: Procesi i auditimit të performancës ka përfshirë periudhën: 2022–2024, gjatë së cilës janë ndërmarrë ndryshime strukturore që kanë ndikuar drejtpërdrejt në kapacitetin për trajtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim. Ne periudhën: 2022-2023 ka funksionuar me vetëm një zyrtar në kuadër të Divizionit për Sigurim të Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim. Me hyrjen në fuqi të Rregullores (ZKM) nr. 09/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MASHTT, është themeluar Divizioni për Arsimin Privat Parauniversitar, ku numri i zyrtarëve është rritur nga një në tre. Divizioni për Arsimin Privat është përgjegjës për licencimin e institucioneve edukativo-arsimore private në të gjitha nivelet: edukimi në fëmijërinë e hershme, arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët dhe i lartë, si dhe arsimi profesional, në përputhje me Ligjin nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e	Raporti i auditimit ka trajtuar në mënyrë të detajuar strukturën organizative të MASHTT-t përgjatë periudhës së auditimit, duke pasqyruar si organizimin paraprak ashtu edhe atë aktual, bazuar në dokumentacionin zyrtar të dorëzuar nga vetë MASHTT. Në faqen 15 të raportit, është theksuar se: “Në vitin 2024 MASHTT ka bërë një ri sistematizim të vendeve të punës, me ç ‘rast është funksionalizuar divizioni specifik për Edukim në Fëmijërinë e Hershme (tuftje DEFH). Paraprakisht EFH ka pasur vetëm një përfaqësues në kuadër të Divizionit për Arsimin e Hershëm dhe Parashkollorë. Në kuadër të DEFH, funksionon Komisioni për licencim, përgjegjës që të shqyrtoj kërkesat për licencimin e kategorive të ndryshme të IP-	

		Hershme dhe Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar. Ndërkohë, monitorimi kryhet nga ky Division, ndërsa mbikëqyrja zyrtare nga Inspektorati i Arsimit. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) nr. 15/2016 nuk përcakton afat të caktuar për aplikim për licencim apo rilicencim, por përcakton që vendimi për licencim/rilicencim të jepet jo më vonë se një muaj para fillimit të vitit të ri shkollor. Po ashtu, Neni 20 i po këtij UA lejon që kërkesat për ndryshimin e kushteve të licencës të dorëzohen në çdo kohë. Brenda Divizionit funksionon komisioni për shqyrtimin e kërkesave, i përbërë nga zyrtarë të MASHTI që kanë përgjegjësi të tjera primare, gjë që ndikon në kohën e trajtimit të lëndëve.	ve, siç janë IP private, IP publiko private dhe IP me bazë në komunitet” Po ashtu, raporti thekson se “Zyrtarët e Komisioni për Licencim, nxjerrin vendime për licencim/ri licencim apo refuzim të kërkesave të paraqitura më së voni një muaj para fillimit të vitit shkollorë”. (Fq 15, paragrafi i pare) “Kemi vërejtur se institucionet parashkolllore të cilat duhet të pajisen me një licencë për të ushtruar veprimtarinë e tyre, dorëzojnë kërkesat në Divizionin për Edukim të Fëmijërisë së Hershëm, gjatë tërë vitit pa ndonjë afat të caktuar kohor dhe kjo mënyrë e licencimit ndikon në aplikime të parregullta, numër të madh të kërkesave, si dhe vëshirëson procesin e shqyrtimit të kërkesave për licencim. Sipas udhëzuesve administrativ licencimi duhet të bëhet së paku një muaj para fillimit të vitit shkollor”. Paragrafi përkatës është formuluar për të shpjeguar shkakun dhe pasojën e kësaj situatë, jo si konstatim i shkeljes së afateve ligjore. Për më tepër, edhe pse në koment përmendet neni 20 i udhëzimit administrativ si bazë për dorëzimin e kërkesave në çdo kohë, nuk ka dëshmi se gjatë periudhës 2022–2024 janë
--	--	---	--

	Gjatë periudhës: 2022–2024 janë pranuar mbi 300 kërkesa për licencim apo rilicencim dhe janë marrë vendime pothuajse për të gjitha këto raste. Numri i raportuar prej 180 institucioneve me licencë valide përfaqëson vetëm institucionet që kanë pasur licencë aktive në momentin e auditimit dhe nuk paraqet numrin e përgjithshëm të licencave të leshuara gjatë kësaj periudhe. Kjo për arsye se brenda të njëjtes periudhe në disa raste janë bërë më shumë se një kërkesë nga i njëjti institucion, pasi që me Udhëzimin administrativ 15/2016 licencat leshohen me afat 1 deri në 3 vite, me crast një pjesë e institucioneve fillimisht kanë marrë licencë njëvjeçare dhe më pas janë rilicencuar për një afat më të gjatë. Rilicencimi është vazhdimësi administrative e licencimit dhe nuk përbën proces të ri. Organizimi i vizitave të terrenit për vlerësim bëhet në mënyrë të koordinuar sipas përkatësisë territoriale dhe jo gjithmonë sipas rendit kronologjik të aplikimit. Kjo ndihmon në përdorimin më efikas të resurseve logjistike dhe njerëzore. Në disa raste, realizohen më shumë se një vizitë për të siguruar pëmbushjen e kushteve të licencimit nga institucionet aplikante. Duke pasur parasysh se komisioni është i përbërë nga zyrtarë me përgjegjësi primare në divizione të tjera, janë të pamangshme disa vonesa dhe trashëgimi të lëndëve nga një vit në tjetrin.	ndryshuar kriteret për licencim ose është zbatuar ndonjë rregull i ri në këtë drejtim. Raporti ka trajtuar gjithashtu procesin e licencimit dhe rilicencimit si një cikël të vazhdueshëm – ashtu siç është përshkruar edhe nga MASHIT – dhe është theksuar në raport se: “Kohëzgjatja e licencës së institucioneve parashkollore, ndryshon sipas stadiit të veprimtarisë. Fillimisht lëshohet për një vit, kurse ri licencimet bëhen deri në tre vite të tjera varësisht nga vlerësimi i komisionit. Më konkretisht kohëzgjatja e licencave është një deri në tre vjet.” Më tutje si shkak pasojë kemi dhënë sqarimet: “Gjatë periudhës 2022–2024 janë paraqitur mbi 300 kërkesa për licencim, prej të cilave vetëm 180 IP janë licencuar. Shumë prej kërkesave janë bartur nga viti në vit dhe sa ju përket shqyrtimit të tyre situata është e paqartë. Numri i kërkesave për licencim të regjistruara në data bazën e DEFH-së, nuk është në përputhje me numrin e institucioneve parashkollore të cilat janë licencuar. Kjo data bazë nuk ofron të dhëna për numrin e kërkesave të pa shqyrtuara dhe të bartura ndër vite.” Procesi i licencimit dhe ri-licencimit janë paraqitur si vijimësi e një procesi ashtu siç po e theksoni edhe ju. Sqarojmë se i vetmi indikator i saktë që kemi mundur ta marrim si bazë për vlerësim ka gene numri I IP-ve të licencuara. Gjatë auditimit kemi kërkuar disa
--	--	---

		Ligji Nr. 04/L-046 për Inspektoratin e Arsimit përcakton ekzistencën e dy profileve të inspektorëve: inspektorë administrativë dhe inspektorë pedagogjikë. Ky ligj nuk parashihet ndarje të inspektorëve sipas niveleve të Standardit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (SNKA) dhe as sipas fushave kurrikulare, çka ka ndikuar në mungesën e specializimit për nivelet specifike, përfshirë arsimin parashkollor. Në raport me mbikëqyrjen e institucioneve parashkollore të licencuara, Inspektorati i Arsimit ka funksionuar me kapacitete të kufizuara, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve të emëruar. Megjithatë, pavarësisht kufizimeve, janë realizuar inspektime tematike që reflektojnë gjendjen reale në terren të institucioneve edukativo-arsimore private në arsimin parashkollor. Inspektimet pedagogjike për këtë nivel pritet të fillojnë vetëm pas miratimit nga MASHIT/DEFH të udhëzimit administrativ dhe udhëzuesit përkatës për vlerësimin e performancës, në përputhje me nenin 20 të UA Nr. 04/2017.	herë data bazën e përditësuar dhe jemi sqaruar me defektet e data bazës. Data baza e DEFH-se nuk e ka sqaruar numrin e kërkesave të barta nga viti në vit, e as numrin e IP-ve të licencuara / ri licencuara brenda vitit. Përndryshe siç edhe kemi shkruar në raport, ne kemi diskutuar edhe raste të kërkesave të pa shqyrtuara asnjëherë në afat prej dy vitesh. Në raport ceket: “Inspektorati i arsimit harton plane dhe raporte të përgjithshme vjetore, në të cilat planifikohet mbikëqyrja e IP-ve. Megjithatë, raportet vjetore përmbajnë vetëm të dhëna statistikore lidhur me numrin e inspektimeve të realizuara brenda vitit kalendarik, pa përfshirë analiza të detajuara mbi zbatimin dhe rezultatet e mbikëqyrjes së e IP-ve, çka kufizon transparencën dhe vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese. Gjithashtu, inspektorati i arsimit nuk posedon rregullore të brendshme, akte nënligjore apo dokumente operative që do ta mundësonin një strukturim më të qartë të funksioneve dhe përgjegjësi të zyrtarëve inspektues. Mungesa më e theksuar identifikohet në aspektin e organizimit të stafit, përkatësisht në mungesën e Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës. Aktualisht, angazhimet e inspektorëve bazohen në përshkrimet e përgjithshëm të përcaktuara me ligjin për Inspektoratin e Arsimit (Shih shtojca 3; Angazhimi i inspektorëve në SIA), pa ndonjë ndarje funksionale sipas niveleve të arsimit.”
--	--	---	---

		Ndërkohë, Inspektorati i Arsimit ka realizuar dhe vazhdon të realizojë inspektime për identifikimin e institucioneve edukativo-arsimore private (IEAPP) që veprojnë me ose pa licencë pune, dhe për këto raste mban evidencë të rregullt. Për ilustrim, SIA Prishtinë, bazuar në raportet vjetore inspektuese, ka realizuar: 24 inspektime në vitin 2022, 21 inspektime në vitin 2023, dhe 14 inspektime në gjysmën e parë të vitit 2024.	Çështja e ndarjes së profileve sipas niveleve është cekur si shkak, jo si e gjetur. Sqarojmë se auditimi i performances përveç që bazohet në ligje dhe rregullore, ka pikë referimi edhe praktikave të mira. Një ndarje e IA sipas niveleve edukative është konstatuar në hulumtimet tona për funksionimin e Inspektoratëve të Arsimit në vendet tjera. Aktivitetet e IA janë cekur për çdo komunë dhe sipas raporteve vjetore që zyrtarët përgjegjës kanë dorëzuar. Më konkretisht, në raport shkruan: “Të dhënat e përgjithshme japin të kuptojmë se gjatë periudhës kohore 2022-2024, Sektori Regional i Inspektimeve në Prishtinë ka arritur të mbuloj 30% të Institucioneve Parashkollore. Karakteristikë e këtij sektori është se në vitin 2024 është ndërmarrë një inspektim i përbashkët me inspektoratin sanitarë dhe të punës në katër institucione parashkollore. Sipas raporteve vjetore të inspektimit, SIA Prizren ka realizuar 31 inspektime në vitin 2022, 9 inspektime në vitin 2023 dhe 21 inspektime në vitin 2024. Të dhënat tregojnë për një rënie të ndjeshme të aktivitetit inspektues në vitin 2023, ndjekur nga një rritje e pjesshme në vitin pasues.
--	--	--	--

		Sa i përket numrit të ulët të ankesave: Vlen të theksohet se palët kanë të drejtë ligjore për të paraqitur ankesë brenda afatëve të përcaktuara. Në të gjitha rastet e refuzuara, ekziston mundësia e riaplikimit për licencim apo rilicencim. Kjo procedurë alternative për riaplikim në praktikë ndikon në zvogëlimin e numrit të ankesave. Gjithashtu, aplikuesit mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre për ankesë edhe gjatë kohës që janë në proces shqyrtimi.	Luhajft ne numrin e inspektimeve tregojnë mungesë konsistence në zbatimin e aktiviteteve inspektuese ndër vite.” Raporti ka paraqitur të dhënat zyrtare të siguruara nga MASHTL, të cilat tregojnë se numri i ankesave të paraqitura për refuzim të licencimit gjatë periudhës 2022–2024 ka qenë shumë i ulët (vetëm 2 deri në 5 raste për vit). Auditi nuk e konteston ekzistencën e të drejtës ligjore për paraqitjen e ankesave dhe as procedurën përkatëse, e cila është përshkruar në raport. Megjithatë, në analizën e bërë është vlerësuar se vonesat në shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe mungesa e afatëve të përcaktuara për dorëzim dhe trajtim të aplikimeve kanë ndikuar që një pjesë e madhe e palëve të mos kenë realisht mundësi për të ushtruar këtë të drejtë, sepse nuk kanë marrë vendime brenda kohës që do t’u lejonte të ankohen. Për këtë arsye, analiza mbi ankesat nuk është përdorur si gjeje më vete, por si një indikator mbështetës në vlerësimin e efikasitetit të përgjithshëm të procesit të licencimit dhe transparencës në komunikim me aplikuesit.
--	--	--	--



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës